

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7667 E martë 2 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"

Pjesëmarrja e ulët në referendumin për emrin në Maqedoni është një pikënisje e keqe për zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Dështimi qartazi i referendumit ...
Vijon në faqen 20

Nga ADELHEID FEILCKE

Dështimi i referendumit në Maqedoni një mësim i hidhur



Opinion Ditës

Unë do të flas për dhunën, por jo me gjuhën e dhunës. E nuk do të ngre gishtin ndaj askujt, përveçse ndaj vetes sime. Dhuna e kohëve të fundit është ...
Vijon në faqen 21

Nga ARLINDA ÇAUSHOLLI

Të pazanët ne



Pranga Vangjel Ballës, në kërkim i vëllai

Vrasja në Dibër pas sherrit dhe pijes, 2 vëllezërit goditën me thikë kushëririn

Përfundon në pranga pronari i lokalit dhe djali, akuzohen se fshehën krimin ndaj Ismail Zogut

ENVER DOÇI

DIBËR - Një ditë pas vrasjes me thikë të 36-vjeçarit Ismail Zogu, policia e Dibrës ka zbardhur ngjarjen e rëndë që ndodhi mbremjen e së dielës në fshatin Arras të këtij rrethi, duke vënë në pranga tre persona si dhe ...
Në faqen 9

INTERVISTA/ VAJZA QË DENONCOI REXHEP RRAJEN: E BERA NGA XHELOZIA

XHISELA: NJE SHUPLAKE E LEHTE, S'ME DHUNOI NJERI

Zbardhet dosja e prokurorisë që la në qeli djalin e deputetit: E goditi Xhiselën me shkelma dhe i tha "dua të vuash, jo të vdesësh direkt"



(Në foto) Xhisela Maloku

Në faqet 2-3

PERPLASJA

"Xhisela", Rama: Dëshpërim opozitar. PD: Qeveria lehtësoi akuzën për Rrajën

Në faqet 4-5

AFATI I APLIKIMIT

Zv/dekania e Mjekësisë, Kreka: 825 kuota masteri, nisin regjistrimet

Në faqen 11

RAPORTI

Skandali, 93% e ilaçeve në farmacitë e QSUT, janë të skaduar

Në faqen 10

NDRYSHIMET

Referendumi në Maqedoni, SHBA: Kuvendi të shohë Kushtetutën e re

Në faqen 17

NGA DASHNOR KALOÇI



Marie Biba: E vërteta e vrasjes së babait tim, Bardhok Biba. Si na trajtoi Enveri

Në faqet 12-13

Aktori i madh në krye të jurisë jep vlerësimin për 14 shfaqjet artistike

Festivali i Teatrove në "skanerin" e Ndrriçim Xhepës

"Trupa jonë nuk është në nivelin e Prishtinës, apo atë të Shkupit"

NGA FATMIRA NIKOLLI

Reshat Arbana, Luiza Xhuvani, Altin Basha, Dino Mustafiç, Kristian Koroveshi, Shkëlzen Veseli etj., janë fituesit e mëdhenj në Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrove mbajtur në Tiranë në datat 23-30 shtator. Mes 'ar'Turbinës'



dhe sallës së Universitetit të Arteve 14 shfaqjet u ndoqën për tetë ditë rresht dhe në fund u vlerësuan nga një juri e përbërë nga Ndrriçim Xhepa, (kryetar juri) dhe anëtar Josif Papagjoni, Shkumbin Istrefi, Luli Bitri dhe Qëndrim Rijani. Të dielën, drejtori ...
Në faqen 18

DOSJA "XHISELA MALOKU" DESHMIA

Zbardhet dosja e prokurorisë: I riu e kanosi me armë dhe i theu telefonin

Rraja e goditi Xhiselën me shkelma: Dua të vuash, jo të vdesësh direkt

I fiku cigaren në trup, më pas i kërkoi falje

Në kërkesën e Prokurorisë së Krutës për caktimin e masës 'arrest me burg' ndaj djalit të deputetit socialist të Fushë-Krutës, Rrahman Rraja zbulohet se ky i fundit e ka kërcënuar me jetë vajzën.

Kërkesa për masën e sigurisë është firmosur më 29 shtator 2018 nga prokurorja Mirela Kapo referuar materialeve të përcjella nga policia e Krutës që më 23 shtator 2018.

PJESË NGA DOKUMENTI I PROKURORISË

Shtetasi Rexhep Rraja prej disa vitesh ka qenë në një raport dashurie me viktimen Xhisela Maloku. Palët janë njohur para shtatë vitesh në komunën Nikël të qytetit të Krutës dhe mes tyre ka pasur një raport intensiv lidhje dashurie.

Konkretisht Shtetasja Xhisela Maloku me banin në komunën Nikël të qytetit të Krutës, fillimisht në datën 21.07.2018, pranë komisaritit numër tre të qytetit të Tiranës, ka kallëzuar faktin se në mënyrë të përsëritur, në episode të përsëritura dhe prej një viti përndiqet nga ana e shtetasit Rexhep Rraja.

Në datën 21.07.2018 përpara of.pol. gjyq në stacionin e Fushë - Krutës shtetasja Xhisela Maloku është shprehur se ka ardhur pranë këtyre ambienteve me qëllim që të tërheqë kallëzimin e bërë pranë komisaritit nr. Tre Tiranë pasi gjithçka është bërë për motive shkelje.

Po në datën 21.07.2018 sikundër rezulton nga aktet e procedimit penal nr.371 të vitit 2018 në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Gentjan Citozi është regjistruar procedimi penal për veprën penale të parashikuar nga neni 248 atë të "Shpërdorimit të detyrës" lidhur me veprimet e paligjshme dhe trajtimin preferencial në ngarkim të të hetuarit Rexhep Rraja.



Rexhep Rraja

Gjithashtu, rezulton se faktet e referuara nga ana e oficerit të policisë gjyqësore janë referuar në mënyrë të cunguar me qëllim lehtësimin e pozitës procedurale të shtetasit Rexhep Rraja.

ÇFARË NDODHI MË 23 KORRIK

E ripyetur lidhur faktin penal, në datën 23.07.2018 viktima Xhisela Maloku shprehur se në vazhdimësi përndiqet nga ana e shtetasit nën hetim Rexhep Rraja dhe se në datën 19.07.2018 pasi është telefonuar nga ana e te hetuarit në mënyrë konsistente dhe janë takuar në vendin e quajtur "hotel Boci" me vendndodhje në rrugën e Rinasit, hotel në të cilën i hetuari ka kërcënuar me armë, i ka thyer telefonin vajzës Sapo janë futur në dhomë personi i hetuar ka filluar të ushtronte dhunë duke e goditur me shkelma, i ka fiku cigaren në trup duke i thënë "trego ku do shkosh se do të të vras...këtu".

Shkak për këtë është bërë një sms dërguar viktimit nga rrethi shoqëror i saj, konkretisht nga shtetasja Suela Zela. Këto kërcënime i hetuari i ka vazhduar për 15 (pesëmbëdhjetë minuta) duke i thënë viktimit "nuk

do të të vras, do të të plagos... dua të vuash e jo të vdesësh direkt.."

Në datën 20.07.2018 viktima është paraqitur pranë komisaritit nr. tre të qytetit të Tiranës me qëllim paraqitjen e ankimit...Po në datën 20.07.2018 viktima dhe i hetuari janë takuar me njeri tjetrin dhe i hetuari i ka kërkuar të falur duke ju lutur.

Viktima është shprehur në mënyrë eksplicite se ... "Mu duk shumë i penduar

ariatit të policisë në stacionin e Fushë Krutës, viktima parashtron faktin se "shtetasia Rexhep Rraja u orvat të më dhunonte..."

Sikundër shprehet viktima në vijim të deklarimeve të saj, Oficeri i policisë gjyqësore Gentjan Citozi ka shkruar gjëra të cilat viktimit i janë sërvirur të mirëqëna me qëllim lehtësimin e pozitës procedurale të autorit të dyshuar. Dhe lidhur me këtë paligjshmëri ka shprehur pakënaqësitë e saj në rrugë ligjore pranë Sh.C.B.A.Durrës.

Me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë, të paanshëm dhe objektiv janë marrë të dhëna në dobi të hetimit nga viktima në datën 30.07.2018 ku ndër të tjerash kjo e fundit shprehet se ... "në datën 19.07.2018 është ushtruar dhunë ndaj saj në vendin e quajtur hotel Boci... pavarësisht se ka qëndruar në hotel nuk ka kryer marrëdhëni seksuale me të hetuarin... më pas dola unë e para dhe ai erdhi më pas duke më përqaftuar dhe duke më bërë lajka...shqetësimet e mia ja kam shprehur edhe rrethit shoqëror...në fillim të vitit 2018 kemi bërë një deklaratë pranë inspektorit të zonës së Fushë Krutës se jam sqaruar me shtetasin Rexhep Rra-



Xhisela Maloku,
dje në "Opinion"

klarim shprehet se palët kanë parakaluar me mjetet e tyre dhe gjatë një manovre të gabuar të mjetit janë konfliktuar, por më pas çdo gjë është sqaruar. Kjo deklaratë rezulton të jetë e fillim vitit 2017.

Me qëllim kryerjen e një hetimi holistik dhe të gjithanshëm në datën 29.09.2018 është ripyetur viktima e cila shprehet se "... Unë jam njohur me shtetasin Rexhep Rraja në vitin 2012 dhe i kam prishur marrëdhëniet me te në vitin 2017. Kjo prishje e lidhjes tona ka qenë kërkesë e Rexhepit fillimisht në muajin Maj 2017.

Prishja përfundimtare mes nesh ka qenë në muajin Korrik 2018, kohe kur unë kam bere kallëzim ne polici ndaj Rexhepit....Përndjekja nga ana e shtetasit Rexhep Rraja përkundrejt meje ka filluar ne muajin Korrik 2017 duke me ndaluar ne rruge, duke me dale përpara rruge dhe duke me telefonuar here pas here me numër te fshehur, duke me detyruar qe unë te qëndroja me te dhe me asnjë tjetër.

Pavarësisht se unë i kam thënë qe nuk doja te vazhdoja lidhjen me te, por unë jam kthyer përsëri tek ai dhe për shkak te dëshirës time. Sikundër e theksova me sipër ndarja ime përfundimtare me te ka qenë ne muajin Korrik 2018. Pas ndarjes përfundimtare ne muajin Korrik 2018, nga ana e Rexhep Rraja nuk kam pasur asnjë shqetësim, ndërsa sikur e theksova me sipër, pas ndarjeve kalimtare ai gjithmonë me dilte ne rruge dhe me detyronte te kthehesha me të".

PAS DHUNES



Xhisela Maloku merret në mbrojtje nga policia

Pas arrestimit të djalit të deputetit Rrahman Rraja i akuzuar për përndjekjen dhe dhunimin e ish-të dashurës Xhisela Malokut, kjo e fundit është marrë në mbrojtje nga policia që prej ditës së djeshme. Dy efektivat të Policisë së Shtetit kanë marrë në mbrojtje vajzën në banesën e saj në fshatin Nikël të Fushë-Krutës, aty ku ajo jeton me familjen. Policia qëndron 24 orë pranë 25-vjeçarës dhe e shoqëron atë në çdo lëvizje. Burime pranë policisë thanë se në mbrojtje është marrë vetëm 25-vjeçarja dhe jo familja e saj. Rexhep Rraja u arrestua dje pas urdhrat të Gjykatës së Krutës, e cila ka dhënë 'Arrest me burg' në mungesë për të riun e akuzuar për përndjekjen dhe dhunimin e Xhisela Malokut. Dhunimi i vajzës u bë publik pak ditë më parë, kur oficeri i policisë Emiljano Nuhu dëshmoi për dhunën e ushtruar ndaj vajzës së re dhe akuzoi policinë për neglizhencë si dhe tregoi se ishte kërcënuar me armë në prani të deputetit Balla.

DOSJA PER RRAJEN

"Personi i hetuar ka filluar të ushtronte dhunë duke e goditur me shkelma, i ka fiku cigaren në trup duke i thënë "trego ku do shkosh se do të të vras...këtu".


dhe vendosa t'i jap një mundësi tjetër...në një moment kur i thashë do shkoj në polici ai u frikësoa dhe me kërkoi të mos të bëja diçka të tillë..."

Më pas viktima në datën 23.07.2018 është paraqitur në Stacionin e Policisë Fushë Krutë dhe brenda është hasur me të hetuarin.

Madje dhe brenda komis-

ja, kjo gjë ka ardhur si pasojë e një kontradite që kemi pasur."

Nga një hetim i thelluar, rezulton se në fashikullin hetimor në datën 28.09.2018 është administruar një deklaratë pajtimi mes shtetasve Anida Maloku (motra e viktimit), Xhisela Maloku (viktima) dhe shtetasit të hetuar Rexhep Rraja. Në de-



Xhisela Maloku, vajza që denoncoi për dhunë ish-të dashurin, Rexhep Rrajën, djalin e deputetit të PS-së, Rrahman Rraja, i mohoi dhe të gjitha denoncimet që bëri vetë në polici.

Maloku foli mbrëmë për emisionet "Open" dhe "Opinion" të gazetarëve Eni Vasili dhe Blendi Fevziu. Në të dyja këto intervista ajo u shpreh se dëshmitë e saj të publikuara në media, ku thuhet që është qëlluar me pjesën e pasme të pistoletës, që është qëlluar me grushte, që i është fukur cigarja në pjesën e kofshëve, nuk janë të vërteta.

"Këto gjëra i kam thënë nga xhelozia dhe inati. Kam bërë dëshmi të rremë", tha Xhisela.

Vajza tregon takimin e fundit me Rexhepin: "Unë kisha bërë një kallëzim në komisariat nr.3, në Tiranë. Ndodhi një konflikt mes nesh. Më mori në telefon dhe u takuam. Nisën skenat e xhelozisë nga ana e të dyve dhe nisën debatet. Në këtë konflikt nuk u ushtrua dhunë ndaj meje. Vetëm një shuplakë e lehtë, jo ato që janë thënë nëpër media. Emiliano (Nuhu) i ka ekzagjeruar. Dëshmia ime nuk është ajo që ka nxjerrë Emiliano, dëshmia ime është në prokurori, bashkë me një dëshmi tjetër në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Durrësit. Atë që ka nxjerrë Emiliano, nuk e di se ku e ka marrë".

Më tej, Xhisela tregon: "Është e vërtetë që më ka marrë telefonin dhe ma ka thyer. Kjo ka ndodhur brenda një hoteli. Në hotel më ftoi Rexhepi. Aty pati zënka normale, vetëm një shuplakë pati në hotel. Në datën 20 kam shkuar në komisariat, por nuk e kam bërë denoncimin. Nuk e bëra sepse u qetësuam. Dola nga komisariat, e takova dhe më kërkoi falje. Ai ishte aty sepse i thashë unë më parë që do e denoncoja. U sqarua dhe m'u mbush mendja që ta fal. Pasi u pajtuam, në datën 21 shkova sërish në komisariat pasi nuk e mbajt fjalën e dhënë. Ai iku me një tjetër me pushime. Atë natë, në datë 20 u nis. E mora vesh nëpërmjet shoqëve. Në fillim nuk i besova, por doli që ishte e vërtetë. Nga inati shkova dhe e denoncova për dhunë".

Në lidhje me aktin e ekspertizës që thotë se ka shenja dhune në trupin e Xhiselës, vajza thotë se shenjat në shpatull janë të vjetra, nga një aksident i mëparshëm.

"Unë nuk e kam lexuar atë ekspertizë, por shenjat në shpatull janë të një aksidentit që kam bërë në Patos. Makina është dërguar në varre-

Vajza që denoncoi Rexhep Rrajën për dhunë: E denoncova nga xhelozia

Xhisela ndërron mendje: Plagët i bëra në aksident, s'më rrahu njeri

"Vetëm një shuplakë e lehtë, më kërkoi falje. Polici Çitozi më tha: Mirë bën që të tërhiqesh"



Xhisela Maloku

za. Unë kam shenjë cigare edhe në vende të tjera, sepse sa herë që ziheshim, digjnim veten. Edhe Rexhepi po ta shikonim, ka dhe ai shenja cigaresh. Nga nervat i bëjmë vetë. Absolutisht nuk po e justifikoj Rexhepin, nuk jam nën presion dhe as nën kërcënim. Nuk e kam pranuar mbrojtjen e prokurorisë. E gjithë kjo është bërë vetëm për një zënkë xhelozie. Nuk më ka djegur me cigare dhe nuk më ka kërcënuar me pistoletë. Thjesht më ka goditur me shuplakë. Nuk e di pse ish-oficeri i policisë më ka nxjerrë mua në media dhe po për-

in e bëra në SHKB, sepse atë natë jemi sqaruar. Sapo e ka tërhequr ai ka ikur përsëri në Sarandë me pushime", thotë Xhisela.

Në intervistën për "Open" me gazetaret Eni Vasili, deklaroi se nuk i ka pëlqyer aspak sjellja e oficerit të Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Fushë-Krujës, Gentian Çitozi.

"Nuk më pëlqeu sjellja e tij. Nuk m'u duk i përshatshëm. Shprehte mendimet e tij, por unë nuk u ndikova. Më thoshte që mirë po bëja që po e tërhiqja dëshminë. Nuk më pëlqeu mënyra se si fliste, por nuk më kujtohet

propë Rexhepin pasi u pendova që tërhuqa dëshminë. Më drejtuan për në SHKB-në e Durrësit. Denoncova Çitozin, jo Rexhepin sepse duheshin arsyet dhe i thashë që kam qenë e kërcënuar. Pasi dhashë këtë dëshmi, është i thirrur Rexhepi. Ai kishte ikur përsëri në Sarandë dhe kjo është arsyeja pse unë shkova për ta ribërë kallëzimin. Inati dhe xhelozia ishin arsyet që shkova në SHKB-në e Durrësit. Kam thënë që jam kërcënuar nga Rexhepi dhe dy kushërinjtë e tij brenda komisariatit, por nuk është e vërtetë. E përsëris, dëshminë e rreme e dhashë nga inati", tregon Xhisela.

Xhisela Maloku: Askush nuk më ka kërcënuar siç është thënë në deklaratën pa firmë.

Blendi Fevziu: Atëherë, në deklaratën që ju kemi dhënë, jeni përgjigjur policisë: Unë e tërhuqa, sepse shtetasi Rexhep Rraja më kërcënoi se do më vriste, ata janë fis kriminelësh dhe rrinë gjithmonë me pistoletë. Unë nuk e kam babain se më është vrarë në vitin 1997 dhe jetoj me mamën dhe motrën.

Xhisela Maloku: Ajo nuk është dëshmi e imja. Atë e ka thënë Emiliano jo unë. Ato që lexuat ju aty, i ka thënë Emiliano.

Pse ju talleshit me po-

licinë?

Po këtë kam bërë... nuk e kam bërë...

A jeni e sigurt për këto që thoni? Mos jeni nën presion?

Kështu është siç them unë. S'jam në presion tani që flas. Nuk më ka thënë që 'jam me pushime dhe sa të vij do të vras', por kam folur me kushëririn e tij, dhe i kam thënë ku je se dua të flasim dhe më ka thënë, 'jam me pushime, nëse ke nevojë unë vij direkt'. Kjo më duket mbështetje jo kërcënim.

"Me të afërmit e tij kam pasur gjithmonë kontakte me ta, me Rexhepin nuk e mbaj mend nëse kam pasur kontakte me të, (pas ndarjes). E kam bërë çdo gjë nga xhelozia... sa më tha që ai ka ikur më të dashurën me pushime.

A jeni ndarë prej dy vitesh ju?

Po, por kështu e kemi lidhjen ne...

Blendi Fevziu: Sipas ekspertëve që kemi pasur në studio është thënë se vetëm dëshmia e parë merret parasysh, pasi të tjerat mund të tërhiqen nën presion. Dëshminë e parë ja kemi dhënë Çitozit apo Emiliano Nuhu?

Xhisela Maloku: Kallëzimin e parë e kam bërë në komisariat nr.3 në Tiranë. Komisarati i Tiranës më ka referuar në Komisaratin e Fushë-Krujës. Por dëshminë e kam dhënë në Tiranë. E kam tërhequr në Fushë-Krujë. Ndërsa të nesërmen, kam shkuar në Durrës për të tërhequr tërheqjen që kisha bërë herën e parë. Pra, në Fushë-Krujë.

Blendi Fevziu: Keni pasur kontakte me Rexhep Rrajën?

Nuk më kujtohet nëse kam pasur kontakte, por me të afërmit e tij kam pasur dhe të kem gjithmonë kontakte. Pas datës 21 nuk e kam takuar më Rexhepin.

Emiljano Nuhu: Më thanë "do të zhdokim, hiq dorë"

News24" dhe "Balkan web" kanë siguruar procesverbalin e kallëzimit të nën komisarit të Krujës, Emiljano Nuhu në komisariat nr.3 në Tiranë. Më 30 korrik 2018, Nuhu kallëzoi në polici se u kërcënuar nga Redjan dhe Ramazan Rraja, nipër të deputetit të PS Rrahman Rraja. Emiljano Nuhu jep detaje në polici në lidhje me bisedën e bërë në lokalit "Rich Mond" ku ndodhi takimi mes tyre.

Oficeri Nuhu pretendon se kushërinjtë Rraja e kanë kërcënuar me jetë duke i thënë se nëse nuk heq dorë nga hetimi i çështjes së Xhiselës do ta zhdokim brenda 24 orëve. Ish-oficeri Emiljano Nuhu ndodhet në një nga vendet e BE-së pas intervistës së tij, ku shprehet se i ishte vënë pistoletë në kokë në sy të deputetit Taulant Balla dhe Rrahman Rraja për çështjen Xhisela', ku ishte i përfshirë djali i Rrajës.

Djalit i deputetit socialist Rrahman Rraja akuzohet për dhunimin e ish-të dashurës Xhisela Maloku. Rexhep Rraja u arrestua dhe pas urdhrit të Gjykatës së Krujës e cila ka dhënë 'Arrest me burg' në mungesë për të riun e akuzuar për dhunimin e Xhisela Malokut. Vendimi i gjykatës vjen edhe pas administrimit të aktit të ekspertizës për të renitë e dhunuar dhe e torturuar nga Rraja. Ai është dërguar në ambientet e drejtorisë së policisë Durrës.

DJEGJET ME CIGARE

"Unë kam shenjë cigare edhe në vende të tjera, sepse sa herë që ziheshim, digjnim veten. Edhe Rexhepi, ka dhe ai shenja cigaresh"

dor njerëzit e pafajshëm, duke nisur nga babai i Rexhepit, deputeti Rrahman Rraja, shprehet Xhisela.

Ajo ka deklaruar se nuk është përdhunuar kurrë dhe se ka raport të mirë me familjen e tij, por edhe me të.

"Në asnjë moment nuk e kam thënë që janë fis kriminelësh, atë e ka thënë Emiljano. Tërheqjen e kallëzimit e kam firmosur, të dyt-

mirë çfarë thoshte pas gjithë këtyre gjërave që ndodhën. Unë menjoh se një oficer policie nuk ka pse të favorizojë asnjë palë. Nuk më kujtohet se çfarë thoshte, por thjesht favorizonte", shprehet Xhisela.

"Pasi dola nga komisariat, shkova te halla që e kam shumë afër, dy minuta larg komisariatit. Të nesërmen shkova që ta denoncoja



Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit noterial kombëtar për venien në funksionim të databazës shtetërore NISA. Dhoma Kombëtare e Noterisë (DH.K.N.) fton Operatorët Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Dokumentat e projektit mund të terhiqen perkundrejt pagesës prej **10.000 leke**, prane Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tirane, Shqipëri. Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

SHPLLALJE ANKANDI
Date 08.10.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallat "Kasmi", Zyrë 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cdi. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandit e tretë për pasurinë e pajalishme të debitorit Luan Zef Palli dhe dorëzueses Loreta Pjetër Palli. "Apartment" me sipërfaqe 88.9 m², nr. pasurie 47162-1-12, zona kadastrale 8631, volumn 6, faqe 20, adresa: Rr. "Gurra", pallati 138, shkalla 1, apartamenti 12, Lezhë. Çmimi fillësor i ankandit të tretë është në shumën 2 177 986 (dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) leke. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyrë 107, Tiranë.

SKANDALI REAGIMET

Arrestimi i Rexhep Rrajës, Tabaku: Për fasadë, synojnë mbylljen e skandalit

Dosja "Rraja", PD: Qeveria lehtësoi akuzën për djalin e deputetit

"Truku i Ramës për mbrojtjen e kriminelëve"

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzoi dje qeverinë se ka lehtësuar akuzën për djalin e deputetit socialist. PD e cilëson provë të pandëshkueshmërisë së krimit nën qeverisjen e Edi Ramës, akuzën për "Përndjekje" ndaj djalit të deputetit socialist, Rrahman Rraja, i cili u denoncua nga ish-nënkomisari i Krujës, Emiljano Nuhu se ka ushtruar dhunë ndaj 25-vjeçarës Xhisela Maloku. Sipas deputetes Jorida Tabaku, arrestimi ngjan si fasadë, ndërsa akuzoi se po synohet mbyllja e skandalit. Deputetja Jorida Tabaku ftoi të gjithë qytetarët që t'i bashkohen protestës së shqërisë civile përpara Kryeministrit në orën 17.30. "Nën mbrojtjen e plotë të kryeministrit të vendit dhe me prokurorinë vegël të Ramës, përdhunuesi me pushtet do të gjykohej për veprën më të lehtë, përndjekjen. Në vend që një përdhunues që kërcënon me armë një vajzë të pambrujtur të gjykohej për krimet e tij më të rënda, pushteti i Edi Ramës i ka garantuar lehtësim të akuzës. Nëse shpallet fajtor, i biri i deputetit do të dalë nga qelia pas 6 muajsh. Ndërkohë, deri më sot për vajzën nuk është ofruar asnjë mbrojtje", u shpreh zj. Tabaku. Ajo shprehu shqetësimin se, "opinion publik u trondit, kur mësoi nga kryeministri se djali përdhunues i deputetit të tij Rrahman Rraja është arrestuar për një akuzë me të cilën ai kishte rënë vetë dakord që më 21 korrik, atë të përndjekjes së vajzës, të cilën e përdhunoi, e torturoi dhe e kërcënoi disa herë me armë". Sipas Tabakut, "të gjitha këto janë vepra të rënda penale, por nën mbrojtjen e plotë të kryeministrit të vendit dhe me prokurorinë vegël të Ramës, përdhunuesi me pushtet do të gjykohej për veprën më të lehtë, përndjekjen. Në vend që një përdhunues që kërcënon me armë një vajzë të pambrujtur të gjykohej për krimet e tij më të rënda, pushteti i Edi



Deputetja Jorida Tabaku

DEKLARATA

PD deklaroi dje se "që prej 21 korrikut, kur Xhisela Maloku bëri denoncim për përdhunim, kanosje me armë dhe kërcënim për jetën ndaj djalit të deputetit socialist Rrahman Rraja, korrektesa e Policisë së Shtetit përfaqësohet vetëm nga nënkomisar Emiljano Nuhu".

"Arrestimi i Rexhep Rrajës, nenet e shkelura"

Berisha: Rama e liroi djalin e deputetit prej 7 veprave penale

Një ditë pas arrestimit të djalit të deputetit të PS, Rrahman Rraja, ish-kryeministri Sali Berisha publikoi në "Facebook" mesazhin e një prokurori. Në këtë mesazh, Berisha shkruan se Rama e "çliron nga 7 vepra penale përdhunuesin e partisë së tij, Rexhep Rraja". Kryepërdhunuesi Edvin Kristaq Rama çliron nga 7 vepra penale përdhunuesin e partisë së tij, Rexhep Rraja! Prokurori dixhital shkruan: "Nga zyra e Edi Ramës doli urdhri i prerë që Rexhep Rraja të akuzohet vetëm për nenin 121/a të përndjekjes. Ndërkohë që janë shkelur në flagrancë nenet që vijojnë: Neni 84- Kanosja - Dënim me gjobë ose burgim gjer në 1 vit. Neni 90. Dëmtime të tjera me



dashje. Dënim me gjobë ose burgim gjer në 6 muaj. Neni 102 - Marrëdhënia seksuale me dhunë me të rritura. Dënim 3 gjer në 10 vjet burgim. Neni 104. Marrëdhënia seksuale ose homoseksuale me kërcënimin me përdorimin e armës. Dënim 5 gjer në 15 vjet burgim. Neni 110 - Heqja e paligjshme e lirisë. E kap pjesa ku shkaktohen edhe



GRIDA DUMA

"Ne kemi problem zbatimin e platformave. Ne kemi një kuadër të mirë ligjor, por problem mbetet moszbatimi. Institucionet me dashje nuk po veprojnë dhe po fshehin krimin. Ngjarje më të rëndë se kjo nuk ka", - tha deputetja e PD-së.

lëndime fizike. Dënim 3 gjer në 7 vjet bur-gim. Neni 278 - Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve. Dënim me gjobë gjer në 7 vjet bur-gim. Neni 301 - Veprime që pengojë zbulimin e së vërtetës. Dënim me gjobë ose burgim gjer në 3 vjet", thuhet në mesazhin drejtuar Berishës.

Ramës i ka garantuar lehtësim të akuzës. Nëse shpallet fajtor, i biri i deputetit do të dalë nga qelia pas 6 muajsh". Deputetja e PD-së deklaroi se ajo çfarë e bën ngjarjen akoma më të rëndë, është se akuzat për përndjekje, është ajo që ra dakord vetë përdhunuesi dhe babai i tij

deputet natën e 21 korrikut, kur në praninë e një oficeri policie detyruan me armë vajzën e torturuar të tërhiqte dëshminë e saj. "Prej asaj nate derisa skandali u bë publik, prokuroria nuk bëri asnjë veprim, megjithëse opozita e ka denoncuar këtë fakt, policia bëri gjithçka për

të fshirë gjurmët e krimit dhe tani thjesht po bëjnë 'show'-n e radhës. Arrestimin për fasadë në shkëmbim të heshjtjes së opinionit publik. Arrestimi i një përdhunuesi me pushtet me akuzën më të lehtë, atë të përndjekjes, është truku që Rama po përdor për të mbylltur kriminelët që i



Gjatë një seance parlamentare

KLAJDA GJOSHA

"Arrestimi vjen 2 muaj pasi është kryer ekspertiza mjeko-ligjore që vërtetonte shenjat e dhunës në trupin e Xhiselës së pambrujtur dhe të terrorizuar. Shqipëria sot ndodhet në udhëkryqin më të rrezikshëm, ku shteti ua ka dorëzuar qeverisjen bandave kriminale dhe ku institucionet kanë ndalur së funksionuar", tha deputetja e LSI.



Protesta, Zhupa: Soreca t'i sigurojë mbrojtje Xhiselës në vendet e BE

Shoqëria Civile dhe opozita protestuan dje përpara Kryeministrit kundër dhunës së ushtruar ndaj Xhisela Malokut nga djali i deputetit të PS, Rrahman Rraja. Përpara protestuesve, zëdhënësjja e PD, Ina Zhupa tha se do t'i drejtohet me një kërkesë ambasadorit të BE, Luigi Soreca që të sigurojë në një nga vendet anëtare të BE-së mbrojtje për Xhiselën dhe familjen e saj. "Unë nuk mund t'i bëj thirrje për mbrojtje këtij shteti. Ç'ti mbrojtje ky shtet Xhiselës, kur i gjithi është i kapur. Po unë kam një thirrje për mbrojtje një ambasadori që i besoj shumë. Ambasadorit të BE, zotit Luigi Soreca. I bëj thirrje që të sigurojë në një nga vendet anëtare të BE mbrojtje dhe siguri fizike, morale dhe psikologjike për Xhiselën, motrën dhe nënën e saj. Nesër këtë kërkesë do ta bëj zyrtare. Mos dëgjoni asgjë që është e falsifikuar dhe që i detyrohet asaj vajzë të thotë tani, dëshminë ajo e ka dhënë atëherë kur ekspertiza mjeko-ligjore vërtetoi dhunë në trupin e saj, çdo gjë tjetër është manipulim dhe frikë", deklaroi zëdhënësjja e PD-së.

sigurojnë atij pushtetin në Krujë dhe Fushë-Krujë. Arrestimi për fasadë ka edhe një qëllim tjetër madhor, mbylljen sa më parë të skandalit dhe të përfshirjes të niveleve më të larta të Partisë Socialiste dhe deputetit Rraja. Për qytetarët dhe për shqiptarët sot po qartësohet çdo ditë e

më shumë se Edi Rama e ka të lidhur fatin e tij politik me kriminelët. Tani është momenti për ta ndaluar këtë pushtet mafioz! Nëse tolerojmë në heshtje, radha që banditët dhe kriminelët të veshur me pushtet të na ndjekin këmba-këmbës do të na vijnë ne dhe fëmijëve tanë".



Arrestimi i djalit të deputetit, Grupi i PS shmang diskutimin. Rraja, kokë më kokë me Ballën

Rama, ironi me PD-në: Arrestim fasadë? Mjerë kush i beson këta të paudhë

Deputeti: Prokuroria të hetojë deri në fund, s'kam bërë presion

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama ironizoi dje akuzat dhe sulmet e Partisë Demokratike në adresë të PS-së dhe të atij vetë, për shkak të rastit "Xhisela Maloku", për të cilin u arrestua djali i deputetit socialist të Krujës, Rrahman Rraja. Në një reagim në rrjetin social "Teitter", Rama shkroi dje se PD po prezantonte "jashtënxjerrjen politike" të radhës. Sipas kreut të qeverisë, Xhisela Maloku është kthyer në mish për top për dëshpërimin e opozitës. "Arrestim fasadë! Ja dhe një prurje e re e jashtënxjerrjes politike mbi vajzën e kthyer në mish për topat e dëshpërimit opozitar! Domethënës sulmi ndaj prokurorisë: gratë prokurore s'janë as gra, as nëna, as vajza po bashkëpunëtore të krimit. Mjerë kush i beson këta të paudhë", u shpreh dje kryeministri. Gjatë ditës së djeshme, kryeministri nuk qëndroi në mbledhjen e grupit parlamentar të PS-së, ku burimet bëjnë me dije se nuk është folur për çështjen e djalit të deputetit Rraja. Rama ka pasur një takim më herët me kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçi në zyrën e këtij të fundit, para mbledhjes së grupit. Ndërkohë, mësohet se deputeti Rraja nuk ka qenë i pranishëm në mbledhjen e grupit, por ka pasur një takim më pas me kreun e grupit, Taulant Balla. Të njëjtat burime nga grupi bëjnë me dije se Balla u ka thënë deputetëve që të vijnë me axhendën e tyre parlamentare, pasi opozita ka "hallet e veta politike". Pas takimit kokë më kokë me kreun e grupit, deputeti Rraja u tha gazetarëve se djali i tij nuk kishte ushtruar dhunë dhe ai nuk kishte pse largohet nga grupi i PS-së. Më pas, përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", Rraja deklaroi se kjo çështje s'ka lidhje me detyrën e tij si politikian dhe fton drejtësinë të hetojë deri në fund. Duke i mëshuar faktit se një baba s'mund të



Kryeministri Edi Rama

ARBEN PËLLUMBI

"Unë besoj që në për momentin kemi një proces penal të hapur, duhet të lejojmë organet e drejtësisë të thonë fjalën e tyre. Nuk na takon ne t'i tregojmë zotit Rraja se çfarë të bëjë", u shpreh sekretari organizativ i PS-së, Arben Pëllumbi, i pyetur në lidhje me rastin e deputetit Rrahman Rraja.

EGLANTINA GJERMANI

Deputetja socialiste e Krujës, Eglantina Gjermeni u shpreh dje se, "rastit i ndodhur së fundmi është një kamberë alarmi për të gjithë ne. Raste të tilla të minimizohen. Unë kam përgjegjësi më shumë se të gjithë ne, kam edhe përgjegjësinë se jam zgjedhur në Krujë".

bëhet prokuror, Rraja distancohet nga çdo lloj kërcënimi apopesioni ndaj oficerit Nuhu për të mbyllur çështjen në ngarkim të djalit të tij. Ai tha gjithashtu se me familjen e Xhiselës, familja e tij ka marrëdhënie miqësore, që nuk kanë për të ndryshuar. "Unë, Rrahman Rraja, për shumë vite kryetar i komunës Nikël

dhe sot deputet i PS, deklaroi: 1. S'kam marrë pjesë në asnjë lloj presioni mbi policinë dhe kam kërkuar dhe kërkoj të hetohet vendodhja ime atë ditë. 2. Mos prisni nga unë që të bëhem prokurori i tim biri dhe mos keqpërdorni fjalën e mia si baba! Po e them shumë qartë që prokuroria duhet ta hetojë çështjen deri në fund". Më tej, deputeti socialist u shpreh: "3. Familja jonë dhe familja e vajzës kanë marrëdhënie të vjetra miqësore, që janë të pandryshuara sot dhe gjithë jetën. 4. Djali dhe vajza kanë pasur një marrëdhënie dashvëqare dhe pavarësisht asaj që mendoj unë, e për-sëris, kjo çështje i takon drejtësisë, jo politikës". Djali i tij, Rexhep Rraja u arrestua dje me akuzën e përndjekjes së ish-të dashurës Xhisela Maloku, me të cilën është ndarë në korrik të 2018-ës. Çështja e Xhiselës trazoi politikën, pasi denoncimi i saj u zbulua rreth tre muaj më pas, kur ish-oficeri i Fushë-Krujës, Emiljano Nuhu nga arratia, akuzoi publikisht se ishte kërcënuar me jetë për të liruar djalin e deputetit.

XHEMAL QEFALIA

I pyetur nga gazetarët, deputeti socialist i qarkut të Tiranës, Xhemal Qefalia tha dje se Rraja nuk ka pse penalizohet si deputet, përderisa nuk ka njoftim nga prokuroria. "Po pse për çfarë dyshohet kolegu im? Për aq kohë sa nuk ka një njoftim prokuroria, atëherë ne nuk mundemi ta penalizojmë", tha Qefalia.



"Xhisela", Romina Kuko: Nuk ka pasur favorizim të askujt, pavarësisht emrit

Zëvendësministria e Brendshme, Romina Kuko deklaroi dje se në rastin e Xhisela Malokut nuk ka pasur favorizim të askujt. Kuko u shpreh se Ministria e Brendshme përtej çdo reagimi e emocional, apo të motivuar politikisht, ripërsërit edhe njëherë qëndrimin e palëkundur institucional duke konfirmuar korrektësinë e veprimeve të Policisë së Shtetit për rastin e Xhisela Malokut. "Gjykojmë të arsyeshme dhe nuk do të reshtim të përsërisim se nuk ka pasur asnjë favorizim të askujt, pavarësisht emrit apo mbiemrit që mban. Ky është momenti të rritshëm se kallëzimi dhe ndjekja penale e të kallëzuarve nuk u mbyllën nga policia dhe se denoncuesja insistoi të tërhiqte padinë", - tha Kuko. Duke treguar dinamikën e ngjarjes dhe veprimin e Policisë së Shtetit, Kuko shpjegoi se, "brenda 24 orëve pati reagim ndëshkues, duke pezulluar dhe procedurë penalisht punonjës in i cili nuk veprimi konform ligjit dhe procedurave e standardeve. E rritshëm se Policia e Shtetit nuk është ndërë e intimiduar nga asnjë palë dhe nga askush dhe veprimet e saj kanë qenë korrekte dhe profesionale, standard që policia ka prej vitesh. Pavarësisht politizimit të skajshëm të këtij rasti për të cilin ndjemë keqardhje të thellë, dua të konfirmoj se Policia e Shtetit trajton duke u referuar të dhënave të vitit të fundit, 4500 raste të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore. Për në lufta kundër dhunës në familje dhe kundër dhunës me bazë gjinore janë nuk janë çështje të ditës, por janë puna jonë e përditshme, ndaj së cilës jemi të dedikuar me vendosmëri", - theksoi Kuko. "Tentativat për përdorimin politik të Policisë së Shtetit kanë si qëllim shfokusimin nga orientimi strategjik dhe operacionel kundër grupeve kriminale. Institucionet nuk bazohen në shpërthime emocionale, por në dispozita ligjore dhe në standarde. Sigurojmë edhe njëherë se policia do mbetet aty, duke e qytetarëve në shërbim të qytetarëve", tha Kuko.

Vasili: Standardi i Ramës, vetëm alibia e çdo lloj llumi

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili i ka kujtuar kryeministrit Rama një deklaratë kur ishte në opozitë, duke shtuar se sot standardi i tij është vetëm një "alibia e çdo lloj llumi goftë ky përdhunim, krim, trafik droge etj., etj". "Dikur 7 vjet më parë në opozitë, Edi Rama zbraste fishekzjarrë dënglash dhe hipokrizie morali me tonelata. Në kongresin e Partisë Socialiste në 6 nëntor 2011 ja ç'thoshte pacipësisht dhe me zë të lartë: 'Pa etikën e lartë të përfaqësimit, që na distanco qartë nga pazarit i gjësë së gjallë së politikës së vjetër, ku valon korrupsioni e korruptimi i shpirtave të dobët dhe i mendjeve të cekëta, ne s'mund ta ngjismim dot Shqipërinë në majën ku duam'. Po sot? Sot standardi i vërtete i Edi Ramës është vetëm një: alibia e çdo lloj llumi, goftë ky përdhunim, krim, trafik droge etj., etj. Ky është standardi që mbrojti Elvis Roshin, Saimir Tahirin, Agron Xhafajn dhe së fundi përdhunuesit e Fushë-Krujës e plot e plot të tjerë kryetar bashkie, drejtorë e nëpunës të lartë", u shpreh Vasili.



NJOFTIM ANKANDI

Permbarruesja Gjyqësore Ermina Mhilli me adresë Lgji, "Oemal Stafa", Rr. "Don Bosko", perballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder njofton se me date 01.10.2018 ora 16:00 ne ambientet e saj do te zhvillohet ankandi i dyle per shijen e pasurise se paluajtshme e lloji:Ndertesë,Kati i pare i perbere nga dy dhoma,banjo,koridor,salion dhe balkon me sip.123 m2, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne z.K.892.Lgji,"Naim Gjylbegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder ne vleren 3.995.040 leke (Tremilion e nentëqind e nentëdhjete e pesëmijë e katërdhjetë leke)

Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder (per pjesemarrjen ne ankand)

Oftertesit te drejtohen prane Zyres se Permbarrueses Gjyqësore Ermina Mhilli, ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel:0692219253 ose adreses se emailit. ermina.mhilli@hotmail.com

NJOFTIM ANKANDI

Permbarruesja Gjyqësore Ermina Mhilli me adresë Lgji, "Oemal Stafa", Rr. "Don Bosko", perballë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder njofton se me date 01.10.2018 ora 16:00 ne ambientet e saj do te zhvillohet ankandi i dyle per shijen e pasurise se paluajtshme e lloji:Ndertesë, Kati perdhje,pa ndaje Dyqan, me sip.113 m2, me nr.radhori 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne z.K.892.Lgji,"Naim Gjylbegu" Rr.Sali Nivica/Shkoder ne vleren 3.303.216 leke (Tremilion e tre mijë e dyqind e gjashtëmbdhjetë leke)

Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder (per pjesemarrjen ne ankand)

Oftertesit te drejtohen prane Zyres se Permbarrueses Gjyqësore Ermina Mhilli, ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel:0692219253 ose adreses se emailit. ermina.mhilli@hotmail.com

PARLAMENTI KOMISIONET

Kryetari i Grupit të PS sqaron ku ndryshon rasti nga Tahiri

Ballaja: Nuk e përjashtojmë Rrajën nga grupi, nuk ka asnjë provë që ai ka bërë presion



akuza në rastin e Tahirit është ngritur nga prokuroria. "Sot, nuk ka një akuzë të ngritur nga prokuroria për këtë çështje", shpjegoi Balla. "Sot jam unë ndërm-

jet prokurorisë së vendit tim dhe thashethemeve të fabrikuara të SHQUP-it me elementë kriminale, që janë disa prej tyre ende në Policinë e Shtetit, që i bëjnë dëm të madh imazhit të shtetit. Ka një dallim të madh. Këtu kemi të bëjmë me një akuzë të ngritur nga një dezertor i policisë. Ditën që do të ketë një akuzë nga prokuroria për këtë çështje, do të ketë një masë dhe dje është marrë vendimi qoftë nga prokuroria, qoftë nga gjykata. Dhe nuk ka një kallëzim nga ana e prokurorisë apo fillin procedim penal, atëherë do

presim deri në fund. Unë po iu them një gjë me bindje: Në fund të kësaj historie, të këtij inskenimi të turpshëm për pjesën e tretë të dosjes, Luzim Basha kësaj radhe nuk do t'ia hedhë paq", shtoi Balla. I pyetur se përse u zgjat dy muaj arrestimi që nga koha e kallëzimit prej vajzës Xhisela Maloku, Balla tha: "Në fakt, kjo është një sëmundje e vjetër në historinë e proceseve në këtë vend. Nuk e di pse u deshën dy muaj e gjysmë, por për mua është trup", thekson ai.



Mblidhet nënkomisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, mungon opozita

Vetingu në polici, Hodo: Vetëm 2% u dorëhoqën, pjesa tjetër në rregull

Felaj: Opozita të depozitojë emrat e anëtarëve të saj

Darina Tanushi

Nënkomisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për vetingun e policisë zhvilloi mbledhjen e radhës, në lidhje me procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Kryetarja e nënkomisionit, Ermonela Felaj u bëri thirrje deputetëve të opozitës të jenë të pranishëm në mbledhjet e nënkomisionit për vetingun e policisë dhe sipas saj, opozita ende nuk ka depozituar emrat e anëtarëve për këtë nënkomision. Gjatë fjalës së saj, Felaj tha se duke u bazuar në nenin 5 të këtij ligji, organet e vlerësimit kalimtar janë: Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Komisioni Qëndror i Vlerësimit, Komisioni Vendor i Vlerësimit. "Organet e Vlerësimit Kalimtar organizohen nga trupa e vlerësimit dhe çdo trupë vlerësimi përbëhet nga tre anëtarë, të cilët caktohen me short nga komisioni përkatës i vlerësimit. Bordi i Përgjdhjes dhe Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit



Kryetarja e nënkomisionit, Ermonela Felaj

janë dy struktura që duhet të iniciojnë fazën e parë të vetingut në radhët e Policisë së Shtetit", tha Felaj. Më tej, zëvendësministri i Brendshëm, Julian Hodo, u shpreh se detyrimi i parë ka qenë dorëzimi i deklaratave individuale të 12 mijë punonjësve të Policisë së Shtetit, GR dhe SHÇB, me qëllim asistimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi dorëzimi. Sipas Hodos, për të tria strukturat u asistua një skemë ndihme. "98% e secilës prej strukturave kanë qenë në rregull, kon-

statohet 2% dorëheqje", tha z.v.ministri Hodo. "Me krijim të Bordit të Përgjdhjes është komunikuar me ILDKP-në, për caktimin e 5 anëtarëve dhe 2 anëtarëve zëvendësues, me universitet për 10 propozime, nga të cilat bordi përgjdhës 5 prej tyre dhe më pas bën shpalljen për 5 anëtarë të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe anëtarët e sekretariatit teknik mbështetës. Procesi i përgjdhjes ka përfunduar në datën 20 qershor, por ende nuk është marrë një

vendim final", sqaroi ndër të tjera Hodo. Më tej, drejtore-sha e përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, znj. Aida Shehi tha se Bordi Përgjdhjes përbëhet nga 5 anëtarë, përkatësisht: znj. Aida Shehi, Ministria e Brendshme; kryetar, z. Fatbardh Zenelaj, Avokati i Popullit; anëtar z. Gjergji Semani, Shërbimi Informativ Shtetëror; anëtar, znj. Ardiana Hala, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; anëtar, znj. Ardita Shehaj, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu, Shehi tha se komisioni vendosi të miratojë edhe një procedurë për marrjen në shqyrtim të kandidatëve, pasi një procedurë e tillë nuk ishte e parashikuar në ligj. "Pas hartimit të një liste me kandidatët të cilët në vlerësimin paraprak plotësonin kriteret e përcaktuara në ligj, listë e cila edhe u publikua, bordi vijoi me shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve. Në disa raste u kërkuar informacion plotësues lidhur me eksperiencat e mëparshme për të shqyrtuar më saktësisht plotësimin ose jo të kriterëve të përcaktuara ligjore", përfundoi Shehi.

Meta takon senatorin amerikan në zyrën e Presidentit të SHBA

Presidenti Ilir Meta në vijim të vizitë së tij në SHBA është takuar edhe me senatorin e Misourit, Roy Blunt. E veçanta e këtij takimi është sepse dy zyrtarët janë takuar në zyrën e ish-Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Harry S. Truman. Fotot e këtij takimi, kreu i shtetit i ka publikuar në "Facebook", ku duket një bisedë shumë miqësore mes tyre. "Në zyrën historike të Presidentit të SHBA, Harry S. Truman, aktualisht zyra e senatorit të Misourit, Roy Blunt, njëkohësisht nënkryetar i Konferencës së Senatorëve Republikanë", shkruan Meta në "FB".



Takimi me Ruçin

Ambasadori i ri i Brazilit: Bashkëshortja ime arbëreshe, rrjedh nga familja e De Radës

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, priti dje ambasadorin e ri të Republikës Federative të Brazilit në Republikën e Shqipërisë, z. Francisco Carlos Ramalho de Carvalho Chagas. Në këtë takim, kryetari i Kuvendit rikonfirmoi interesin dhe angazhimin e Shqipërisë për nxitjen e marrëdhënieve e të bashkëpunimit dypalësh me Brazilin. Për z. Ruçi, fakti që të dyja vendet sapo kanë emëruar ambasadorë të rinj, përbën një moment të duhur për konsolidimin e këtij bashkëpunimi. "Marrëveshjet, bashkëpunimi dhe miqësia midis të dy vendeve, - nënvizoi kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, - shkurtrojnë distancën gjeografike midis vendeve tona. Për këtë, - vijoi z. Ruçi - mund të mbështesin edhe dhomat dypalëshe të hapura në të dy vendet". Z. Ruçi shprehu kënaqësinë për mbështetjen nga Brazili të kandidatës së Shqipërisë si anëtarë e përkohshme e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për periudhën 2022-2023. Ambasadori Francisco Carlos Ramalho de Carvalho Chagas falënderoi kryetarin e Kuvendit, Gramoz Ruçin, për vullnetin për nxitjen e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Brazilit dhe theksoi se bashkë me institucionet shqiptare do të eksplorojë fushat e mundshme të zgjerimit të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Brazilit, sidomos rritjen e investimeve braziliane në Shqipëri. "Kam një arsye më shumë për të shërbyer në Shqipëri dhe nxitur bashkëpunimin Shqipëri-Brazil - nënvizoi ambasadori Chagas. - Bashkëshortja ime është arbëreshe dhe rrjedh nga familja e poetit të madh De Rada", tha ambasadori i ri i Brazilit.



Për një muaj bëhen bashkë gjermanë dhe shqiptarë në aktivitete të ndryshme kulturore

Teatri Kombëtar, Schutz: Po i ndjekim debatet me vëmendje

"Ambasada gjermane, ende nuk ka një qëndrim"

Për një muaj me radhë do të bëhen "bashkë gjermanë dhe shqiptarë në aktivitete të ndryshme kulturore". Ambasada gjermane në Tiranë prezantoi dje programin për "Tetorin Gjerman", ku do të ketë aktivitete në Tiranë dhe qytete të tjera në vend. Për të dymbëdhjetin radhazi, muaji gjerman kulturor do të vijë nën moton "Frymëzuar nga njerëzit", ndërsa në lidhje me Teatrin Kombëtar, ambasadorja u shpreh se po i ndjek zhvillimet me vëmendje. Për 12 herë radhazi, këtë vit "Tetori Gjerman" vjen i frymëzuar nga njerëzit. Programi do të bëjë bashkë artistë gjermanë dhe shqiptarë, ndërsa shkëmbimi i mendimeve do të përfshijë jo vetëm elementet lidhës i "Tetorit Gjerman". "Mototja e javëve gjermane do të jetë e frymëzuar nga njerëzit, ku do të bëhen bashkë gjermanë dhe shqiptarë në aktivitete të ndryshme kulturore", deklaroi ambasadorja gjermane, Susanne Schütz. Ndërsa, lidhur me debatin për Teatrin Kombëtar, ambasadorja gjermane, Susanne Schütz, nuk preferoi të mbante një qëndrim të qartë, por tha se po i ndjek me vëmendje zhvillimet. "Ambasada gjermane nuk ka një qëndrim për Teatrin Kombëtar. E kemi lexuar me shumë vëmendje letrën e KE-së, si dhe kemi në vëmendje zhvillimet në vend", deklaroi Susanne Schütz. Filma, letërsia, teatri, muzikë, kulinarë dhe diskutime të ndryshme do të shohin



Ambasadorja gjermane, Susanne Schütz

qërojnë aktivitetet në Tiranë dhe qytete të tjera në vend. Temat e diskutimeve do të kenë në qendër të diskutimeve përballjen në të shkuarën historike. Përgjatë gjashtë javëve në vijim në Tiranë dhe qytete të tjera të Shqipërisë do të zhvillohen aktivitete të ndryshme në kuadër të "Tetorit Gjerman". Programi

që partnerët e shumtë të "Tetorit Gjerman" kanë hartuar, përfshin filma dhe letërsi, teater, zbulime kulinarë, muzikë dhe vallëzim sikurse diskutime dhe uorkshop-e. Gjermania vazhdon të jetë një mbështetëse e fortë e Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritetit të plotë evropian. Një gjë të tillë e


ka bërë të qartë edhe vetë kancelarja gjermane, Angela Merkel, e cila edhe dje deklaroi se Ballkani ka vuajtur nga lufta dhe duhet të anëtarësohet në BE. "Për hir të paqes, - tha zonja Merkel, - ne gjithashtu duhet t'u japim vendeve të Ballkanit Perëndimor mundësinë e anëtarësimit, edhe pse kjo është e ndërlikuar. Kur ndonjëherë lexoj raportet e agjencive tona mbi çështjen e korrupsionit në vendet e Ballkanit Perëndimor, edhe unë shqetësohem", theksoi kancelarja gjermane. Por kur mendon se çfarë lufte ka pasur atje pak kohë më parë dhe sa e brishtë është situata, atëherë është në interes të saj strategjik t'u japim këtyre vendeve një perspektivë evropiane, edhe pse përsëri kjo do të kërkojë një numër vitesh", tha ajo.

"E pashqetësuar për opozitën e Bashës"

Bregu: Jam në PD derisa të më shpallin "armike"

Ish-deputeti e PD, Majlinda Bregu, që aktualisht mban postin e Sekretares së Përgjithshme të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal deklaroi se në PD do të jetë derisa ta shpallin "armike". "Tanimë kam një detyrë tjetër, e kjo nuk më jep komoditetin për të thënë të gjitha ato që mendoj, por besoj se nuk do të zhgënjeheni nëse ky premtime shtatori do të bëhet premtime tetori, e më pas nëntori", u shpreh ajo në "TCH" duke theksuar se, "nuk ka asgjë të re që mund të ndodhi me establishmentin e PD". Në studion e "Top Talk", ajo duket se nuk është shpresëplotë për të ardhmen e saj në Partinë Demokratike. "Nuk jam e shqetësuar fare për opozitën e Lulzim Bashës, sepse opozita e Lulzim Bashës është opozita më fitimprurëse në këtë vend. Unë vijoj të jem 'de juro' anëtare e Partisë Demokratike, derisa për të më nxjerrë jashtë listës elektorale të shohë edhe emrin si armik i saj", u shpreh Majlinda Bregu.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQUARUR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje makine shkatërrimi monedhash metalike për nevojat e Bankes së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqëruar me ftesa direkte kandidateve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 17,775,400 Lekë ose 93,300 Euro**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hailili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10:00 – 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje makine shkatërrimi monedhash metalike për nevojat e Bankes së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **06 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST
 (CONSULTING SERVICES – INDIVIDUAL SELECTION)
 Trust Fund Grant for Development of Public Sector Accounting
 Consulting Service
 For
 Local Project Coordinator

ALBANIA
 Project: Trust Fund Grant for Development of Public Sector Accounting
 Grant No.: TFGA277 (Portion A); TFGA5134 (Portion B)
 Assignment Title: Local Project Coordinator
 Reference No.: AL-CFCU-58029-CS-INDV

The Government of Republic of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Trust Fund Grant for Development of Public Sector Accounting, and intends to apply part of the proceeds for consulting services.

The focus of the proposed project is on two levels: i) the strengthening of the legal, regulatory and professional development of public sector accounting and financial reporting by developing a system based on international standards, and ii) the relative capacity building for implementation. The approach used will be that of gradual introduction of the IPSAS, in line with IT and treasury system developments, whilst developing the professional capabilities of MOFE and public sector finance professionals.

The objective of the assignment is expected to provide support to the Ministry of Finance and Economy's PIT, and other project stakeholders in the day to day management and coordination of implementation of all three project components and other activities (going beyond the activities of the project) to implement the Public Sector Accounting Reform. The consultant will provide assistance to the Project Director and the Project Implementation Team (PIT) in managing the implementation of project activities by facilitating the coordination and establishing effective communication between the PIT, General Directorate of Treasury, and other internal and external project stakeholders, the PIT and consultants, the PIT and steering committee, the PIT and CFCU. She/he will also be responsible for the drafting of progress reports and providing quality input in the preparation of the Terms of Reference. She/he will also provide assistance in change management, communication and raising awareness activities to support public sector accounting reform implementation.

The required assignment ("the Services") include providing assistance to the project implementation team (PIT) with regard to coordination of activities as envisaged in the project documents, and implementation plan; support the unit responsible for accounting methodology, PIT, internal and external beneficiaries in all areas of project implementation; monitor and follow up on all project activities in timely, efficient and transparent manner, including all financial reporting from CFCU and progress reporting from PIT, Treasury and relevant units within the Ministry of Finance and Economy, etc.

This is a part time assignment. The effort level is maximum 150 days spread during the project implementation period, which may be spent in the premises of the Ministry of Finance and Economy or off site.

The assignment is expected to commence in November 2018, and is expected to terminate upon in June 2020.

The detailed Terms of Reference (ToR) for the assignment can be found at the following website: cfcu.financa.gov.al

The consultant will work off site and on the premises of the Ministry of Finance and Economy (MOFE). MOFE shall provide the Consultant with the required office space, logistics, administrative support, premises for meetings and other similar resources needed to set up presentations in the framework of this assignment. The consultant should have:

- A Master degree in Business Administration or Master in Accounting and Finance
- Professional title in accounting would be an advantage.
- At least 5 years prior work experience in similar project coordination and/or management.
- Knowledge about the World Bank procedures would be an advantage.
- Knowledge on and understanding of Financial Reporting in Albania.
- Excellent knowledge of English and Albanian.
- Ability to write concise reports.
- Ability to communicate and coordinate efficiently and problem solving orientation.

The attention of interested Consultants is drawn to Section III, paragraphs 3.14, 3.16, and 3.17 of the World Bank's "Procurement Regulations for IFP Borrowers" July 2016 ("Procurement Regulations"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest. A consultant will be selected in accordance with the *Open Competitive Selection of Individual Consultants (IC)* method set out in the Procurement Regulations, *Time Based Contract*.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays.

Expressions of interest (CV, Cover letter and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by fax, or by e-mail within October 16th 2018, local time 12:00.

Mrs. Enkëlejda Kokthi, General Director
 Central Finance and Contracting Unit (CFCU)
 Ministry of Finance and Economy
enkolejda.kokthi@financa.gov.al
cfcu.financa.gov.al
 "Dëshmorët e Kombit" Blvd. No.3, Tirana, Albania
 Tel: + 355 4 24 51 180

Ministri Bushati: Inkurajoj drejtësinë, shpifjet nuk i shërbejnë integrimit



1 i vrarë e 7 të plagosur, arrestohen shqiptari dhe rumuni

Hetimet ndaj mjekëve e infermierëve, Manastirliu: Të sqarohet situata

"Çështja i përket prokurorisë. Respektoj bluzat e bardha dhe organet e drejtësisë"

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu dhe ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati ishin dje në Shkodër, në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve. Teksa inau-guroi edhe qendrën e re, Manastirliu foli dhe për çështjen e arrestimeve në spitalin e Shkodrës. Ajo kërkoi që kjo situatë të sqarohet sa më shpejt, ndërsa u tregua e balancuar duke thënë se respekton bluzat e bardha, por edhe organet e drejtësisë. "Shpresoj që kjo situatë të sqarohet sa më shpejt. Si ministere e shëndetësisë kam respekt maksimal për bluzat e bardha dhe për shërbimet që ata ofrojnë për qytetarët. Si nëpunëse dhe përsëri, si ministere respektoj të gjithë organet e pavarura për të kryer të gjitha procedurat dhe shpresoj shumë në sqarimin e kësaj çështjeje", deklaroi ministria. Ndërkohë, ministri Bushati shprehu inkurajimin për drejtësinë dhe institucionet në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, ndërsa ftoi opozitën të bëhet pjesë e procesit. Nga ana tjetër, Bushati deklaroi se trillimet dhe shpifjet nuk i shërbejnë procesit të integrimit evropian.

MINISTRIA MANASTIRLIU

Pak ditë pas "furtunës" në Spitalin Rajonal të Shkodrës, ku 9 punonjës të këtij institucioni shëndetësor, mes të cilëve dy ish-drejtuës përfunduan me masën e sigurisë "Arrest me burg" dhe "Arrest shtëpie" për abuzim me tenderët e ilaçeve, ka ardhur prononcimi i ministres së Shëndetësisë. E ndërsa kërkoi, sqarimin sa më shpejt të çështjes, Ogerta Manastirliu u shmanj një qëndrimi të saj nëse qëndron apo jo akuzat ndaj mjekëve dhe infermierëve të spitalit të Shkodrës duke qenë se blerjet dhe tenderët për stendat që ata akuzohen janë bërë nga vetë ministria në fjalë. Manastirliu tha se "kjo është një çështje që i përket prokurorisë dhe unë nuk do të doja që me asnjë fjalë timen të influencoj mbaj organet e pavarura". E pyetur nëse hetimi ndaj mjekëve dhe infermierëve mund të ndikojë në largimin nga Shqipëria të bluzave të bardha, sëris ministria preferoi t'i shmanget pyetjes duke u përqendruar se e rëndësishme për të dhe për qytetarët është që shërbimi i hemodinamikës në spitalin e Shkodrës nuk ka pësuar së funksionuari. Ajo u shpreh se



Ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, dje në Shkodër



Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, dje në Shkodër

ARRESTIMI I BLUZAVE TË BARDHA

Dhjetë ditë më parë, nëntë punonjës të Spitalit Rajonal të Shkodrës, mes të cilëve dy ish-drejtuës përfunduan me masën e sigurisë "Arrest me burg" dhe "Arrest shtëpie". Burime nga prokuroria bënë me dije se ata akuzohen se kanë shpërdoruar detyrën, duke blerë ilaçe dhe medikamente mjekësore jashtë kriterëve dhe kapacitetit të spitalit. Arrestimi i mjekëve dhe infermierëve, mori shkas pas një auditimi të bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në spitalin e qytetit verior, nga ku u konstatua se ishin bërë shkelje tek reparti i hemodinamikës e kardiologjisë

"ministria ka marrë masat për të sjellë në Shkodër hemodinamistët me masën e sigurisë "Arrest me burg" dhe "Arrest shtëpie". Burime nga prokuroria bënë me dije se ata akuzohen se kanë shpërdoruar detyrën, duke blerë ilaçe dhe medikamente mjekësore jashtë kriterëve dhe kapacitetit të spitalit. Arrestimi i mjekëve dhe infermierëve, mori shkas pas një auditimi të bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në spitalin e qytetit verior, nga ku u konstatua se ishin bërë shkelje tek reparti i hemodinamikës e kardiologjisë

DEKLARATA E MINISTRIT BUSHATI

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati është i shqetësuar për nivelin e debatit politik në Shqipëri që sipas tij shpesh herë prodhon shpifje duke ndikuar kështu nega-

tivisht në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE. "Situata politike natyrisht e bazuar mbi trillime dhe shpifje, duke përfshirë edhe Shkodrën nuk është një atmosferë apo terren i përshtatshëm për të ecur më shpejt në procesin e integrimit evropian. Duhet të them që proceset që mediat u referohen janë kërkesë e qytetarëve të këtij vendi se sa e komunitetit ndërkombëtar. Detyrat tona janë të qarta, duhet të vazhdojmë të punojmë pa kompromis ndaj krimit të organizuar, duhet të luftojmë korrupsionin, duhet të vazhdojmë me të njëjtën shpejtësi ndërhyrjen kirurgjikale që ka nisur në pallatin e drejtësisë dhe këto reforma do kenë impakt pozitiv edhe për sa i përket procesit të integrimit evropian. Procesi Screenin filloi javën që shkoi dhe në vazhdimësi do ketë seanca më të posaçme në shërbim të Komisionit Europian të Tiranë", tha Bushati. Ai iu përgjigj edhe akuzave të opozitës në adresë të tij. "Nga gënjeshtarët patologjikë është

shumë e vështirë për të pritur të vërteta. Më vjen keq që vendi ka këtë opozitë, e cila ka frikë nga e vërteta, ka frikë nga Institucionet, ka frikë nga Komisioni i Venecias, sepse ndoshta është e vetmja opozitë në Europë dhe botë që ka një frikë të tillë, por, nga ana tjetër, duhet të

tregohemi të gjithë të duruar me opozitën, e cila ka humbur besimin te vota, ka humbur besimin te koncepti alternativ ndaj qeverisë. Për sa kohë e ka humbur këtë besim nuk është se do të presim ditë më të mira në këtë drejtim por thjesht shpreh keqardhjen time më të madhe për nivelin e debatit, për shpifjet që tentojnë të helmojnë hapësirën publike dhe, nga ana tjetër, dua t'i bëj thirrje të gjitha institucioneve të shtetit të së drejtës të vazhdojnë luftën pa kompromis kundër krimit dhe kundër korrupsionit. Shpresoj që edhe opozita të bëjë të njëjtën gjë", deklaroi Bushati.

Shoferi "spion" arreston 7 shqiptarë në kamionin Holandë-Angli

HOLANDË - Shtatë shqiptarë e kanë pësuar paraditen e djeshme nga një shofer kamioni në Holandë. Teksa po tentonin t'i ngjiteshin kamionit të linjës Holandë-Angli, shoferi ka lajmëruar menjëherë policinë ku me pas u bë dhe arrestimi i tyre. Sipas të dhënave, shqiptarët po synonin të largoheshin drejt Mbretërisë së Bashkuar, ndërsa

fshehja në kamionë ishte një praktikë, e cila mendohet të jetë aplikuar edhe nga shqiptarë të tjerë. Të arrestuarit janë të moshave nga 16-26 vjeç, ndërsa identiteti i tyre nuk bëhet i ditur. Ngjarja ndodhi në zonën e Moerdijk. Kjo pikë kalimi shërbente si "shteg" për shqiptarët, që përmes fshehjes në kamionë, arrinin të kalonin në tokën angleze, përcjell "politie.nl" Pas kon-



trolleve të kryera, rezultoi se në 4 prej 7 të arrestuarve rëndonte akuzat e dhunës, ndërsa dy të tjerë ishin kapur edhe më parë në tentativa për t'u larguar drejt Anglisë.

Njoftim për shitje me ankand te dyte

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e dorëzuesin K S të ndodhura në Panahora Mallakaster. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga : Pasuria "Ara" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me sipërfaqe 2500 m2 ZK 2869 Mallakaster, me cmim 840.000 leke. Pasuria "Ara" nr.206/7 me 4. faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869 Mallakaster, me cmim 56.000 lek/Pasuria "me nr. 70/15, vol.6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në ZK 2869 dhe ndodhet në Mallakaster me çmimin në masë 280.465 lekë.

Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet ditë 18.10.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1, Kati 2, zyra 5. Kont tel. 672082543, e-maili: llir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com

Permbareuesi Gjyqësor Privat Çezar Beja

Permbareuesi Gjyqësor Privat Çezar Beja me adrese Lagja Nr 2, Rruga "A.Goga", Qendra "Eden" Kt 3, Durrës, Tel: 0674053771, email cezarbeja@hotmail.com

Shtipi ankandin e trete per pasurite e pajalteshme te debitorit Hysni Vath Gjergji, Reparta Rrahman Gjergji, Raji Hysni Gjergji

1.Lloji i prones: "ARE", Nr Pas 9/4, ZK 3137, Vol 4, Fq 78, Sip 2950m2, Adresa Rade, Njesia Administrative Manez, Bashkia Dures

Cmimi ankandit te trete eshte 2.509.166 leke

2.Lloji i prones: "ARE", Nr Pas 38/33, ZK 3137, Vol 5, Fq 82, Sip 2590m2, Adresa Rade, Njesia Administrative Manez, Bashkia Dures

Cmimi ankandit te trete eshte 4.273.236 leke

Ankandi do te zhvillohet ne zyrën e permbareuesit gjyqësor privat Çezar Beja ne datën 10.10.2018 duke u mbyllur ne orën 16.00

Shoqëria permbareimore JUSTITIA

shpall ankandin, faza e para për shitjen e pasurisë së pajalteshme sipas Çertifikatës provizore per regjistrimin karabinas: Pasuri e pajalteshme, Apartament me sipërfaqe 70m², e regjistruar në regjistrim hipotekor me Nr.117, datë 28.04.2009, me Nr. Pasurie 62/1-1, në Zonën Kadastrale 3126, me Adresë: Shëngjin, Lezhë, regjistruar në emër të Shaban Elezi dhe Taze Smailaj, hipotekor në favor te BKT BANK.

Çmimi me të cilin liron shpita me ankand është 2.400.000 (dy milion e katërqind mijë) lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 16.10.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbareuesit gjyqësor, me adrese Bulvardi "Bajram Curri", Palli 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890/0693177499

Përfundojnë në pranga pronari i lokalit dhe djali i tij, fshehën krimin

Enver Doçi

DIBËR

Vrasja në Dibër, dy vëllezërit goditën me thikë nipin pas sherrit në lokal

Ngjarja nën efektin e alkoolit, arrestohet Vangjel Balla, shpallet në kërkim i vëllai

Një ditë pas vrasjes me thikë të 36-vjeçarit Ismail Zogu, policia e Dibrës ka zbardhur ngjarjen e rëndë që ndodhi mbrëmjen e së dielës në fshatin Arras të këtij rrethi, duke vënë në pranga tre persona si dhe duke shpallur në kërkim një tjetër. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Dibrës dhe nën drejtimin e komandantit të policisë së Qarkut të Dibrës, dy vëllezërit Aleksandër dhe Vangjel Balla, përkatësisht 23 dhe 20 vjeç, pas një sherrit për motive të dobëta. Pas hetimeve intensive, blutë kanë vënë në pranga njërin prej të dyshuarve si autor të krimit. Bëhet fjalë për 20-vjeçarin Vangjel Balla (djali i dajës së viktimës) nga fshati Muhur, ndërsa ka shpallur në kërkim vëllain e tij, Aleksandrin (autorin kryesor). Ndërkohë, në lidhje me këtë ngjarje janë arrestuar pronari i lokalit, Sami Lusha, 56 vjeç si dhe djali 25-vjeçar i këtij të fundit, Blerim Lusha, të dy banues në fshatin Arras. Mësohet se babë e bir akuzohen për veprën penale: "Moskallëzim krimi".

VRASJA

Mbrëmjen e së dielës, 36-vjeçari Ismail Zogu, banues në fshatin Sinë ka shkuar për të pirë kafë në lokalin e Sami Lushës në fshatin Arras. Në këtë lokal kanë qenë edhe dy djemtë e dajës së tij, Aleksandër dhe Vangjel Balla. Mësohet se tre personat në fjalë, nën efektin e alkoolit kanë nisur të debatojnë ashpër me njëri-tjetrin, ndërsa shërri ka degjeneruar deri në përleshje. Në grindje e sipër, Aleksandër Balla ka nxjerrë thikën dhe ka goditur Zogun, duke e lënë të plagosur rëndë. I plagosuri ka humbur jetën gjatë transportimit për në qytetin e Peshkopisë. Ndërsa, dy autorët e krimit, vëllezërit Balla janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes me një furgon të bardhë. Pas sinjalizimit për vrasjen e 36-vjeçarit, policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, hetuesit e çështjes kanë sekuestruar një sërë provash që çuan në zbardhjen dhe dokumentimin e ngjarjes. Gjatë kontrollit të ushtruar në furgonin me të cilën u larguan autorët, në njërin nga "xhepat" e dyerve anësore është gjetur edhe thika, me të cilën dyshohet se është kryer vrasja e të riut. Ndërkaj, mësohet se viktimat dhe autorët ishin konfliktuar edhe para disa ditësh për motive që ende nuk bëhen me dije.

ARRESTIMI

Falë hetimeve të kryera, blutë kanë mundur identifikimin dhe arrestimin e njërit prej autorëve të



Furgoni me të cilën u larguan autorët e vrasjes



vrasjes së 36-vjeçarit Ismail Zogu dhe konkretisht të 20-vjeçarit Vangjel Balla. Ndërsa po punohet për kapjen e vëllait të tij, Aleksandrit. "Nga veprimet hetimore të kryera nga grupi i posaçëm i hetimit, i ngritur për zbardhjen e vrasjes së ndodhur në orët e mbrëmjes të datës 30.09.2018, dyshohet se shtetasi Aleksandër Balla (i shpallur në kërkim), gjatë një konflikti për motive të dobëta në lokalin e shtetasit Sami Lusha në fshatin Arras në bashkëpunim me vëllain e tij Vangjel Balla (i arrestuar) kanë vrarë me thikë shtetasin I.Z., 36 vjeç, banues në

fshatin Sinë, njësi Administrative Arras. Nga veprimet e kryera dyshohet se shtetasi Sami Lusha dhe djali i tij, Blerim Lusha, në bashkëpunim me njëritjetrin nuk kanë kallëzuar për rrethanat e krimit. Materialet hetimore do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Dibër për Vangjel e Aleksandër Ballën për veprën penale "Vrasje me paramendim", kryer në bashkëpunim dhe për shtetasit Sami dhe Blerim Lusha për veprën penale "Moskallëzim krimi, kryer në bashkëpunim", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Dibrës.

PERSONAT E ARRESTUAR

1. Vangjel Balla, 20 vjeç, banues në fshatin Muhur.
2. Sami Lusha, 56 vjeç, banues në fshatin Arras.
3. Blerim Lusha, 25 vjeç, banues në fshatin Arras.

NË KËRKIM

Aleksandër Balla, 23 vjeç, banues në fshatin Muhur (autori kryesor i krimit).

Prokuroria: Ja si iu zvatën paratë klientit

Mashtrimi me 74 milionë lekë, paditën 3 punonjëse banke dhe biznesmeni

TIRANË - Një biznesmen dhe tre punonjëse të një banke të nivelit të dytë akuzohen nga prokuroria se përmes mashtrimit i zvatën shtetasit Ardian D., shumë prej 740 milionë lekësh të vjetra. Nën akuzë për mashtrim janë vënë biznesmeni Lefter Sulka dhe punonjëset e bankës Anila Bushi, Vilma Gode dhe Valbona Derhemi, të cilat dyshohen se duke shfrytëzuar besimin e klientit Ardian D. e kanë bindur këtë të fundit të hedhë në llogarinë e shoqërisë "Sulka" shumë e majme. Mësohet se D. i kishte depozituar paratë në një llogari në bankë dhe duke u besuar punonjëseve të saj, ka pranuar t'i kalojë lekët në llogarinë e kompanisë



Prokuroria e Tiranës

"Sulka". Ndërkaj, prokuroria i akuzon tri punonjëset e bankës, se kanë vepruar për llogari të biznesmenit Sulka dhe e kanë bindur D. se ai ka mundësi për t'ia

kthyer paratë, pasi kryen transaksione të mëdha bankare. Në dosje thuhet se D. ka mundur të marrë mbrapsht vetëm shumë prej rreth 15 milionë lekësh.

PERSONAT NËN HETIM

1. Lefter Sulka, biznesmen
2. Anila Bushi, punonjëse banke
3. Vilma Gode, punonjëse banke
4. Valbona Derhemi, punonjëse banke

Organi i akuzës padit edhe bankën për mashtrim, pasi ka dyshime se ka shkelur manualin, duke mos mbrojtur interesat e klientëve. **kl.la.**

SHKURT

Armë e fishekë në banesë, babë e bir në pranga

TIRANË - Babë e bir kanë rënë në prangat e Policisë së Tiranës, pasi iu gjetën arsenal armësh në banesë. Në kuadër të operacionit të koduar "Paskuqan 2", u arrestuan në flagrante shtetasi Azis Xhini, 70 vjeç dhe Faris Xhini, 19 vjeç, banues në Kamëz. Sipas bluve, për personat në fjalë disponohet informacion në rrugë operative se në banesë mbanin sende të kundraligjshme. Gjatë kontrollit, atyre iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale një pistoletë, një automatik, 460 fishekë arme të gjatë, 38 fishekë pistolette, 3 kërra automatiku, 7 kërra pistolette, vula rrethore dhe drejtëkëndore dhe kuti boje për vula. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur për veprat penale "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" dhe "Falsifikimi i vulave dhe i stampave ose i formularëve" të kryera në bashkëpunim.

Digjet makina e drejtoreshës së Qendrës Sociale

TIRANË - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm është djegur një makinë në Tiranë. Sipas burimeve policore, ngjarja ndodhi rreth orës 02:50, në rrugën "Hamdi Cenoimeri". Blutë bëjnë me dije se mjeti tip "Benz", me targë AA550TN, është në pronësi të shtetas M. A., drejtoreshë e Qendrës Sociale në Kombinat. Nga hetimet para-prake dyshohet për zjarvën të qëllimshme. Ndërkaj, blutë po punojnë intensivisht për identifikimin dhe kapjen e autorit. Materialet në lidhje me këtë ngjarje i janë përcjellë për hetime të mëtejshme prokurorisë.

Raporti i BIRN: "Gangrenë" e sistemit shëndetësor, pasojat i vuajnë pacientët

Skandali, 93% e ilaçeve në farmacinë qendrore të QSUT, të skaduara

Asnjë reagim nga instancat përgjegjëse

Rreth 93 për qind e medikamenteve që gjenden në farmacinë qendrore të QSUT-së janë të skaduara, dëm i cili u akumulua vit pas viti në 447 milionë lekë, ndërkohë që qindra pacientë vuajnë pasojat e mungesës së barnave. Mungesa e medikamenteve mjekësore është një ndër shqetësimet kryesore të qindra pacientëve dhe familjarëve të tyre dhe një "gangrenë" e vazhdueshme e sistemit shëndetësor në Shqipëri përgjatë dy dekadave të fundit. Megjithatë, "një mal" me ilaçe të skaduara u ngrit vit pas viti në farmacinë qendrore të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, ndërkohë që të sëmuretë po vuajnë pasojat e mungesës të tyre. BIRN siguroi një raport inventari të medikamenteve që gjendeshin në farmacinë qendrore të QSUT-së deri më 9 maj 2018 dhe i përpunoi të dhënat, pasi i hodhi ato në një databazë. Analiza e përfutur tregon se rreth 93 për qind e ilaçeve në farmacinë qendrore janë të skaduara dhe vetëm 7 për qind e tyre ishin ende të përdorshme për pacientët. Medikamentet që gjenden në QSUT u përkasin viteve 2012-2018 dhe kapin një kosto totale kontabël prej 481.8 milionë lekësh



Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë

(rreth 3.9 milionë euro). Nga këto ilaçe me vlerë kontabël 447 milionë lekë rezultojnë të skaduara dhe vetëm 34.7 milionë brenda afatit të përdorimit. Grumbullimi i stokut të madh të ilaçeve të skaduara në farmacinë qendrore të QSUT është konsideruar një problem serioz

edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, KLSH. Në dy raporte auditit për vitet 2014 dhe 2015, KLSH konstatoi se kishin shkuar dëm tonelata medikamentesh të tenderuara apo të dhuruara në Qendrën Spitalore Universitare dhe fajësonte për këtë keqmenaxhimin, por edhe prak-

tikën e tenderimit të medikamenteve në prag të datës së tyre të skadencës. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" nuk iu përgjigj pyetjeve të BIRN mbi arsyet e krijimit të stokut në farmacinë qendrore si dhe dëmin e dyfish-të të shkaktuar ndaj pa-

ANALIZA

Analiza e përfutur tregon se rreth 93% e ilaçeve në farmacinë qendrore janë të skaduara dhe vetëm 7 për qind e tyre ishin ende të përdorshme për pacientët. Medikamentet që gjenden në QSUT u përkasin viteve 2012-2018 dhe kapin një kosto totale kontabël prej 481.8 milionë lekësh.

cientëve dhe buxhetit të shtetit. Në një përgjigje me shkrim, QSUT pretendoi se trajtimi i kërkesës për të drejtë informimi kërkonte afat kohor të gjatë dhe të paparashikueshëm për t'u përpunuar, si dhe burime njerëzore shtesë, për shkak të dokumentacionit voluminoz.



Klosi: Rafting, mundësi punësimi, ka 80 vende për ta ushtruar

Duke parë interesin e madh të turistëve të huaj në sportin e rafting, si edhe interesin e shtuar nga shqiptarët gjatë viteve të fundit, Federata Shqiptare e Rafting hap mundësitë për një profesion të ri, siç është instruktori i rafting. Të drejtosh një gomone pa motor, vetëm me lopatë! Ditën e hënë 20 kandidatëve nga Tirana, Berati, Skrapari, Përmeti dhe Elbasani të trajnuar sipas standardeve ndërkombëtare iu shpërndanë certifikatat për të punuar si instruktorë rafting. Certifikatat u shpërndanë nga Federata Shqiptare e Rafting dhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi si investim për një turizëm aventurë me standard nga profesionistë të njohur ligjërisht edhe në arenën ndërkombëtare. Por, edhe si një dritare e re punësimi për të rinjtë.

Kryebashkiaku Erion Veliaj: Më tepër kujdes për gjyshërit

Dita Botërore e të Moshuarve, rehabilitohet qendra në Shkodër

Shtëpia e të Moshuarve në Shkodër është rehabilituar tërësisht me një investim prej 110 milionë lekësh nga buxheti i shtetit. Në Ditën Botërore të të Moshuarve, ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu dhe ministri Bushati vizituan ambientet e reja të Shtëpisë së të Moshuarve në Shkodër. "Kemi detyrimin të investojmë për të moshuarit, për kontributin që kanë dhënë për shoqërinë, posaçërisht për ata që kanë më shumë nevojë, ndaj siç investuam këtu në Shkodër, rrijtësojmë rrejtin e institucioneve të përkujdesit për të moshuarit pa përkrahje në të gjithë vendin", u shpreh ministria Manastirliu. Ndërkohë, ministri Bushati tha se kjo qendër është një model suksesi. "Kjo qendër do shërbejë si model suksesi. Kur po vizitoja sot këtë qendër, më erdhi në mend një thënie e Nënë Terezës, e cila thotë 'kemi ardhur në jetë për të bërë gjëra të vogla me dashuri të madhe' dhe puna e ekipit të ministres Manastirliu dhe qeverisë e dëshmojnë më së miri këtë", u shpreh ministri Bushati. Investimi në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër nuk



Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, në Ditën Botërore të të Moshuarve

është i vetmi. "Brenda 6 muajsh e do të hapim Shtëpinë e të Moshuarve në Palasë dhe do të rrijtësojmë institucionet e përkujdesit në të gjithë vendin", tha Manastirliu. Duke synuar krijimin e një sistemi të unifikuar të ofrimit të shërbimeve të integruara shoqërore dhe shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka mundësuar edhe vizitat e specializuara për secilin nga 299 të moshuarve në qendrat tona rezidenciale. "Në kuadër të reformimit të sistemit të shër-

bimeve të kujdesit shoqëror kemi miratuar standardet e shërbimit të asistencës shtëpiake për të moshuarit, duke hedhur një hap të rëndësishëm për rrijtjen e kujdesit social për të moshuarit në nevojë", - tha Manastirliu. Ndërkohë kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj në Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve zgjodhi që kafën e mëngjesit ta pijë me gjyshe e gjyshër pensionistë. Ai u uroi zgëzuar 1 Tetorit dhe bisedoi për disa nga nismat e ndërmarrja në përmirësimin e infras-

strukturës së qytetit. "Në emër të Këshillit Bashkiak dhe qytetarëve të Tiranës dua t'u uroj të gjithë gjysheve dhe gjyshërve 'Gëzuar 1 Tetorin!'. Kam edhe një thirrje për nipat dhe mbesat: kjo është dita kur një gjyshe ose një gjysheje që kemi harruar t'i çoni një mesazh, t'i bëni një vizitë, t'i çoni një dhuratë të vogël në shtëpi. Kjo është dita për t'i kujtuar ata. Unë besoj se një qytet është i mirë, kur kemi një harmoni mes brezave, mes atyre që ndërtuan Shqipërinë që kemi sot dhe po

ia kalojnë stafetën Shqipërisë që duam për nesër", tha Veliaj. Bashkia e Tiranës rikthen edhe një nga nismat më interesante që është zbatuar ndonjëherë në kryeqytet, atë të kafes me gjyshërit dhe gjysht pensionistë, të cilët në disa lokale mund ta konsumojnë kafën me cim të reduktuar. Teksa vlerësoi rrijtjen e frymës së humanizimit dhe të vullnetarizmit edhe tek të rinjtë, Veliaj i bëri apel të gjithë shoqërisë për më shumë përkujdesje për të moshuarit. "Mezi pres që të

299

TË MOSHUAR
Duke synuar krijimin e një sistemi të unifikuar të ofrimit të shërbimeve të integruara shoqërore dhe shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka mundësuar edhe vizitat e specializuara për secilin nga 299 të moshuarve në qendrat tona rezidenciale.

shoh sot, por edhe gjatë gjithë vitit, më shumë të rinj që kujtojnë gjeneratën e vjetër dhe pranojnë që nuk kemi ardhur nga hiçi. Kemi ardhur nga dikush, kemi ardhur nga një traditë, kemi një histori. Fakti që e kujtojmë këtë histori, na bën nder të gjithëve", tha Veliaj.

PRANIMET NË MASTER INTERVISTA

Voltiza Duro

Universiteti i Mjekësisë ka nisur aplikimet për programet e studimit master shkencor dhe profesional. Kandidatët e interesuar kanë në dispozicion plot 825 kuota, ku mund të regjistrohen deri në 12 tetor të këtij viti. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", zv.dekania e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, prof. asoc. Manika Kreka tregon kriteret dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë kandidatët e interesuar për t'u shpallur fitues në programin e studimit të parapëlqyer në master. Më tej ajo bën me dije se deri më tani, kërkesat më të shumta nga studentët janë në degët Infermieria, Fizioterapia dhe Imazheria.

Disa ditë më parë kanë nisur aplikimet për programet e studimit master në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. Kur është afati i fundit i regjistrimeve?

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kanë filluar aplikimet në programin e ciklit të dytë të studimeve, master profesional dhe master i shkencave. Regjistrimet kanë filluar në datën 24.09.2018 dhe do të përfundojnë në 12.10.2018 (në përputhje me Udhëzimin nr. 26, datë 30.07.2018 të MASR).

Sa është numri i kuotave të vëna në dispozicion për të gjitha degët si në master shkencor dhe në profesional?

Kuotat e miratuara në programin master i shkencave janë 300 dhe në masterin profesional janë 525 për vitin e ri akademik 2018-2019. Pra, në total kemi vënë në dispozicion 825 kuota për të gjithë të interesuarit.

Cilat janë disa prej programeve të studimit master që ofron Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike?

Programet e studimit në master i shkencave janë Fizioterapi, Logopedi, Teknik Laboratori, Teknik Imazherie, Mami dhe Infermieria. Ndërkohë, masteri profesional ofron programe studimi në Menaxhim

Prof. asoc. Manika Kreka: Infermieria, Fizioterapia dhe Imazheria, degët më të kërkuara

Mjekësia nis regjistrimet në master, 825 kuota për studentët

Zv.dekania: *Kujdes, ja afati i fundit i aplikimeve*



Zv.dekania e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, prof. asoc. Manika Kreka

him Infermieror, Logopedi, Fizioterapi, Teknik Laboratori, Teknik Imazherie, Mami. Madje, shumë shpejt presim vendimin përfundimtar për çeljen e një programi të shtatë studimi master profesional në Kujdes Paliativ.

Cilat janë kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për t'u përzgjedhur fitues?

Aplikantët duhet të kenë mbaruar ciklin e parë të studimeve bachelor. Për programin e studimit master i shkencave në "Infermieria" dhe masterin profesional në "Menaxhim Infermieror" mund të aplikojnë studentët që zotërojnë një diplomë bachelor në Infermieria dhe Përgjithshme dhe Mami. Për programin e studimit master i shkencave dhe masterin profesional në Mami mund të aplikojnë studentët që zotërojnë një diplomë bachelor në Infermieria dhe Përgjithshme dhe Mami. Për programin e studimit master i shkencave dhe masterin profesional në Teknikë Laboratori mund të aplikojnë studentët që zotërojnë një diplomë bachelor në Teknikë Laboratori, Biokimi, Biologji,

Kimi dhe diploma të ngjashme me to. Për programin e studimit master i shkencave dhe masterin profesional në Infermieria dhe Përgjithshme dhe Mami mund të aplikojnë studentët që zotërojnë një diplomë bachelor në Fizioterapi.

Programet e studimit në master i shkencave janë Fizioterapi, Logopedi, Teknik Laboratori, Teknik Imazherie, Mami dhe Infermieria. Ndërkohë, masteri profesional ofron programe studimi në Menaxhim Infermieror, Logopedi, Fizioterapi, Teknik Laboratori, Teknik Imazherie, Mami.

Kimi dhe diploma të ngjashme me to. Për programin e studimit master i shkencave dhe masterin profesional në Infermieria dhe Përgjithshme dhe Mami mund të aplikojnë studentët që zotërojnë një diplomë bachelor në Fizioterapi.

Për programin e studimit master i shkencave dhe masterin profesional në Teknikë Imazherie mund të aplikojnë aplikojnë stu-

dentët që zotërojnë një diplomë bachelor në Teknikë Imazherie dhe Fizikë. Për programin e studimit master i shkencave dhe masterin profesional në Logopedi mund të aplikojnë studentët që zotërojnë një diplomë bachelor në Logopedi, Gjuhësi, Shkenca Sociale, Psikologji dhe Pedagogji Cikli i ulët dhe diploma të ngjashme me to.

Sa do të jetë koeficienti që do të aplikohet në llogaritjen e pikëve përfundimtare sipas universitetit ku është mbaruar bachelor-i?

Për studentët të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve pranë FSHMT-së ose që dorëzojnë një diplomë Universitare Europiane do të aplikohet koeficienti 1.2 në llogaritjen e pikëve përfundimtare. Për studentët të cilët kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në të gjitha universitetet e tjera shtetërore dhe private do të aplikohet koeficienti 1 në llogaritjen e pikëve përfundimtare. Studentët do të rankohen sipas pikëve që do të përfitojnë sipas formulës së mëposhtme:

Koeficienti i përcaktuar shumëzuar me mesataren

525

KUOTA, MASTER PROFESSIONAL

Kuotat e miratuara në programin master i shkencave janë 300 dhe në masterin profesional janë 525 për vitin e ri akademik 2018-2019. Pra, në total kemi vënë në dispozicion 825 kuota për të gjithë të interesuarit.

12

TETOR, AFATI

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, kanë filluar aplikimet në programin e ciklit të dytë të studimeve, master profesional dhe master i shkencave. Regjistrimet kanë filluar në datën 24.09.2018 dhe do të përfundojnë në 12.10.2018

e ponderuar të cilët të parë të studimeve bachelor. *(1 x mesatare e ponderuar) *;(1.2 x mesatare e ponderuar). Në programin e studimit master i shkencave do të kenë mundësi zgjedhje për t'u regjistruar studentët të cilët kanë mesatare 7 (shtatë) dhe që do të paraqesin dëshminë e gjuhës së huaj sipas Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Më pas kandidatët do të rankohen sipas pikëzimit dhe do të shpallen fituesit. Regjistrimi përfundimtar do të bëhet brenda datës 30 tetor 2018.

Cilat janë degët më të kërkuara nga studentët deri më tani?

Degët më të shumta kërkesa janë Infermieria, fizioterapia dhe Imazheria, kjo për momentin.

Cili është dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët?

Aplikimet në programet e studimit të cilët të dytë të studimeve (master) me kohë të plotë, do të bëhen pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike duke filluar nga data 24 shtator 2018 deri në datën 12 tetor 2018, në orarin 8.00-16.00, pranë sekretarisë

mësimore. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij (deklarata notoriale) me dokumentacionin e mëposhtëm: diplomë, ose fotokopje të saj të njëzuar me origjinalin, të cilët të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë, e shoqëruar me listën e notave ku shprehjet edhe nota mesatare e ponderuar. Gjithashtu, duhet të dorëzojnë edhe diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njëzuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore - DAR/ZA, një formular aplikimi, fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim, pasaportë, dy fotografi personale, kopjen e mandatit të pagesës si dhe një deklaratë e nënshkruar nga kandidati aplikant. Për studentët aplikantë në programin e masterit të shkencave kërkohet certifikata e njohjes së gjuhës së huaj (minimalisht niveli B1), e detyrueshme në momentin e aplikimit.

INTERVISTA SPECIALE

Nga Dashnor Kaloçi

Me ndërmjetësinë e mikut tonë, Preng Përgjetanit, një veterani të nderuar mirditas, kuadër drejtues i Kulturës në qytetin e Rrëshenit për disa dekada me radhë e, gjithashtu, një nga të paktët njerëz që ka mbetur në Mirditë nga ata që e kanë njohur nga afër Bardhok Bibën, madje "mek e dashamer" i familjes Biba, pa shumë mundim arrijmë të takohemi me znj. Marie Biba, diku në një nga lokale të qytetit të Rrëshenit. Sapo mëson arsyen e ardhjes sonë nga Tirana, Maria, duket si e zënë në faj dhe e qorton Preng Përgjetantin, duke i thënë "mos na korit", dhe na fton ta ndjekim pas për në shtëpinë e saj, e cila ndodhet fare pranë, diku në katin e katërt të një pallati të ndërtuar me periudhën e komunizmit. Derën e shtëpisë na e hap bashkëshorti i Maries, njëku i njohur, Zef Prenga, i cili na fton të ulemi në një nga dhomat e apartamentit të tyre të thjeshtë dhe të mobiluar me po ato "rraqe", siç kanë qenë pothuaj të gjitha familjet shqiptare në ato vite të "periudhës së lavdishme" të regjimit komunist. Duket sikur koha nuk ka lëvizur fare pasi asgjë nuk ka ndryshuar tek ajo shtëpi për afro katër dekada e kusur kur ata janë martuar dhe kanë hyrë seftë në atë apartament, "dhomë e kuzhinë" siç thuhet atëherë. Edhe pse Maria ka pasur poste drejtuese në Mirditë, si deputete dhe Kryetare e Bashkisë së Rrëshenit dhe bashkëshorti, Zefi, gjithashtu, një mjek tepër human dhe me emër të madh në të gjithë qarkun, (nga Laçi, Lezha dhe Mirdita ku ai ka punuar për vite me radhë), duket se ato poste, detyra dhe funksione që kanë pasur, nuk ua kanë ndryshuar aspak karakterin e tyre dhe çdo punë e kanë kryer me nder. Gjë e cila duke qartë edhe nga jetesa e thjeshtë e tyre, por që na e treguan edhe mjaft mirditas që patëm rastin të takojmë dhe intervistojmë aty në qytetin e Rrëshenit, ku Maria vazhdon të gëzojë një popullaritet të madh nga "të dy krahët" edhe sot e kësaj dite që është vetëm një qytetare e thjeshtë. Pas prezantimit me grupin tonë të xhirimit që ka shkuar enkas në Mirditë për të realizuar disa intervista për një dokumentar ku në qendër është historia e babait të saj, Bardhok Bibës, pas një ngurrimi të natyrshëm për të rrëfyer atë histori të dhimbshme jo vetëm për atë, por edhe për dhjetëra familje mirditore, Maria na vë në dispozicion dokumente, foto, albume dhe disa relike të rralla që ajo ka ruajtur dhe i ruan me fanatizëm të rrallë, kujtim nga babai i saj që atë e la vetëm pak më shumë se një vjeçe. Në in-

Ekskluzive / Intervista e rrallë e Marie Bibës, e bija e ish-deputetit dhe sekretarit të parë të partisë të rrethit të Mirditës, i cili u vra nga Komiteti i Maleve në gushtin e vitit 1949

"Ju tregoj të vërtetën e vrasjes së babait tim, Bardhok Biba"

Dëshmia: "Si e trajtoi Enveri familjen tonë dhe çfarë më shkruante Ndue Pjetër Gjonmarkaj i Komitetit të Maleve në letrën që më dërgoi pas vitit 1991"



tervistën e saj, Marie Biba flet për herë të parë lidhur me historinë e vërtetë të babait të saj Bardhok Biba, nga shkollimi në Orosh dhe në Shkodër; lidhja me grupet komuniste; vrasja e tij prej Komitetit të Maleve; bisedat e gjyshit me Mehmet Shehun pas vrasjes; ceremoninë e madhe të varrimit; kujdesin e madh që tregoi Enveri për familjen e tyre; si dërgoi Ilirin me Teutën në dasmën e saj në Rrëshen, ftesat që i bënte duke e thërritur në Tiranë dhe duke kërcyer valle me të dhe ora që Enveri i bëri dhuratë; si e gjeti Maria në Degën e Brendshme të Rrëshenit; letrën që i kishin lënë mbi kuftomën e të atit Komiteti i Maleve; refuzimi për t'u takuar me Ndue Pjetër Gjonmarkun pas vitit 1991 dhe çfarë i shkruante ai në letrën që dërgoi asaj?!

Znj. Marie, a mund të na thoni shkurtimisht, kush ishte babai juaj, Bardhok Biba, prejardhja e familjes së

tij, shkollimi dhe si ra ai në kontakt me idetë komuniste?

Babai im, Bardhok Biba, ka lindur në 28 janar 1920 në Bulshar të Mirditës, në një familje të varfër. Kjo familje është e lidhur me familjen e Gjonmarkajve, pra pjesë e asaj familje. Baba ka mbaruar në shkollën e Oroshit 7-vjeçare dhe prej andej ka shku në gjimnazin e Shkodrës. Disa mësuës që vinin në shkollën e Oroshit ishin shkodranë, ju ka pëlqy si fëmijë dhe pastaj në gjimnaz ka ra në kontakt me grupet komuniste të asaj kohe, me Tom Kolën dhe Nazmi Rushtin dhe ka fillu të përqafojë ato ide. Është zbulu që një ndër ta ishte edhe im at që merrej me kto grupe komuniste dhe për këtë gjë është përfshu nga shkolla dhe në vitin 1940-te, është çu me xhandar në Orosh, në familje. Pastaj meqenëse ishte pak larg qëndrave, kto kan pas një shtëpi të vogël edhe në Qafë Mollë, me afër qytetit, aty ka ndëjt gjatë kohës. Meqenëse kishte

edhe vetë interes, ishte i lidhur me grupet e Shkodrës, të Pukës, fillu pastaj veprimtarinë e vet. Pastaj është pranë parti në '43-shin dhe është fut në çetën Pukë-Mirditë. Ka qenë gjithashtu komisar politik në batalionin "Perlat Rexhepi". Kto që ju them ai i ka shkruar vetë të gjitha në biografinë e tij

Po mbas mbarimit të Luftës e në vazhdim?

Ka qenë edhe Kryetar Fronti, ka qenë edhe Sekretar i Parë i rrethit të Mirditës. Ka qenë edhe delegat i Kongresit të parë të PPSH. Është zgjedh edhe deputet. Ka kry veprimtarinë e tij edhe politike, është perpek t'i bindi njerëz të rrugën që kishte marrë vendi ynë dhe për luftën Nacional-Çlirimtare dhe ka punu deri në '49-ën.

Thuhet se gjatë kësaj periudhe, pra nga mbarimi i Luftës dhe deri në gushtin e vitit 1949, Bardhok Biba ka ndihmuar disa njerëz që kanë qenë të arratisur në male,



duke u dërguar fjalë që ata të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe duke u premtuar që të mos dënoheshin?

Nga ata të cilët kanë dalë në mal në atë kohë, ka shumë njerëz, ka edhe persona që më kanë thënë personalisht, që; mu më ka kthyer Bardhok Biba në rrugë. Kam qenë në mal, kam bisedu me të, nuk kam pas problem me njerëz dhe me shtetin dhe jam kthyer e jam gjallë në sajë të atij. Ai ka punu me kta, i ka afru...

Si është e vërteta e ngjarjes së 7 gushtit të vitit 1949, përse shkoi Bardhoku në atë vend ku i bë dhe prita?

Në prill të '49 ka ardh qendra e rrethit nga Shpali në Rrëshen. Në fillim kanë qenë vetëm shtëpitë e fshatarëve. Kanë qenë 3-4 kulla, kulla e Jakajve, kulla e Gjet Dudës dhe kjo kullë është marrë për zyra. Ka qenë që do të mblidhnin në vullnetarë për hekurudhat. Kuptohet që të gjitha rrethet kishin detyrimet e veta. Edhe Mirdita kishte një plan. Janë shpërndarë të gjithë nëpër zona dhe ka ardh një njoftim që në zonën e Kaçinarit nuk po dalin shumë vullnetarë. Edhe ka shku vetë. Ka shku në Orosh, ka bërë një takim me popullin. Ka qenë natyrë shumë popullore, nuk ka qenë njeri me kriju konf-

likte dhe ka shku me idenë që nuk kam pse të kem roje, me idenë që mirditorët nuk më vrasin.

Ka pasur shoqërues me vete?

Ka pas një polic me vete. Ka qenë edhe një njeri i veti, edhe ai ka pas një armë dhe mbasi kanë bërë mbledhjen e takimin, e do vinin, baba ka ec përpara atyre. Ata i kanë zënë pritë në një pozicion shumë të saktë për ta dhe fatal për atë.

Meqenëse ka qenë i pari, e kanë gjujt dy herë. Edhe vetë ka pas një armë, automatik me vete. Gjujten e parë e ka marrë në gjoks. Gjujten e dytë e ka marrë duke u kthyer për me nxjerrë armën. Është vra. Aty kan gjujt kta që kishte me vete, njeri, se tjetrit si ka ashtu pushka dhe e kanë lënë aty dhe nuk kanë mujt me e lëviz, sepse shkonin me idenë që po akuzohemi për atë që ndodhi.

Kush ishin ata që i bënë pritën babait tuaj dhe qëlluan mbi të?

Në vrasjen e tij...ato kan ardh si grup.... kan ardh nga Italia. Atëherë dihej që kanë qenë kto grupet. (Kanë koincidu edhe me provokacionet e 2 gushtit në Jug). Ata kanë ardh me avion, kanë zbarku.....

Thuhet se atë ditë ka pasur edhe bashkëshorten me vete, pra nënën tuaj?



Po në atë takim ka pas edhe nanën me vete, por ajo ishte në një takim me gratë. Nana ka ndigju edhe armët dhe ka marrë rrugën andej nga kanë dëgju armët. Kanë taku në rrugë një gru me një femijë dhe i ka thënë: "A di gjë, ç'a ishin ato arme"? Ajo u ka tanë: "Unë kam pa gjithi zi dhe terr; (siç thotë populli), se kanë vra Bardhok Bibën", pa e dit se kush ishin kto që po e pyesnin. Nana e ka pyet prap: "Vdekun"? "Po"-i ka thënë ajo. "Me sa pashë unë, vdekur".

Çka ndodhur më pas?

E kanë prurë pastaj në Rrëshen dhe është bërë ceremonia e varrimit. Për kohën është bërë një ceremoni madhështore. Kanë qenë pothuajse mirditorët shumicë. Edhe dikush që mund të kishte diçka, (pra probleme) ka ardh, me thënë që s'jam unë, ndoshta. Ka qenë edhe një organizim shtetëror, sepse ishte edhe deputet edhe Sekretar i Parë i Mirditës. Ceremonia mortore e babës tim është bërë madhështore për kohën.

Kush ka qenë nga udhëheqja e lartë e Tiranës?

Në atë ceremoni ka qenë Mehmet Shehu edhe Gjini Pjetër Markatoma, gjenerali. Ata të dy e kanë pas arkivolin në krah. Kam pas gjyshin gjallë në atë kohë dhe atij i ka pas thënë Mehmet Shehu: "Ne do t'i nxjerrim ujin e zi Mirditës". Gjyshi ka qenë një plak i urtë, i zgjuar dhe i ka thënë: "Mua nuk më ka faj e gjithë Mirdita. N.q.s. jeni të zotë me gjet doracin, është tjetër punë,

por Mirdita mua s'më ka borxh". Ishte femija i dytë, djalë që i vritej. I kanë vra edhe vllain babës tim, në moshën 18 vjeçare në Orosh. Nëna ime ka qenë 21 vjeçe atëhere.

Si kanë qenë marrëdhëniet e babait tuaj me gjeneralin e famshëm mirditor, Gjini Marka Toma?

Me Gjini Markun baba ka pas marrëdhënie shumë të mira. Bile unë me nanën kam shku njëhere tek Gjini Marku. Kishite ai një problem dhe kemi shku e kemi bisedu me të në familje. Kam njohur edhe të jemen që ishte gjallë atëherë...

Është thënë dhe shkruar se pak kohë para vrasjes, Bardhok Biba nuk i ka pasur mirë punët dhe raportet me udhëheqjen e lartë të Tiranës, gjë për të cilën thuhet se ai edhe nuk u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror në Kongresin e parë të PKSH-së në nëntorin e vitit 1948. Dini ndonjë gjë ju rreth kësaj...?

Në atë kongres mund të ketë qenë edhe ndërhyrja e Gjinit që Bardhoku t'u zgjidhte anëtar i Komitetit Qendror i Partisë Komuniste, por në Kongres është çu dikush nga Veriu dhe e ka trajtë Bardhok Bibën si derë Gjonmarku. "Të jete edhe ca kohë në provë, se ai është Gjonmarkaj" dhe kështu baba nuk është zgjedh në atë kongres. Me sa di unë, e ka taku edhe Enveri edhe Gjini dhe i kanë thënë: "Mos na mbaj inat, se shokët e tu, nukë dinë se kush je ti". (Gjini Marka Toma

në atë kohë ishte zv/ministër i Mbrojtjes dhe pritej që në atë Kongres, të zgjidhej kandidat apo anëtar i Byrosë Politike. Por kjo gjë nuk ndodhi, pasi Gjini jo vetëm nuk e sulmoi Koci Xoxen, siç bënë pjesa më e madhe e udhëheqjes së lartë të nxitur nga Enveri, por u mundua ta shfajsonte, duke thënë që: Koci nuk ka ndërmarë asnjë veprim pa dijeninë e Partisë dhe çdo gjë është bërë në mënyrë kolegjiale. Shënimi ynë, D.K.)

Enver Hoxha ka qenë disa herë në Mirditë dhe te shtëpia e gjyshit tuaj, gjë e cila dihet tashmë dhe nga foto të ndryshme. Si e ka trajtuar familjen e gjyshit tuaj Enver Hoxha?

Po Enver Hoxha ka qenë disa herë në shtëpinë tonë. Në fillim është bërë një takim në Rubik që do të shkonte për Hydrocentralin në Ulëz. Aty është taku nëna ime me të dhe gjyshi. Enver Hoxha i thënë se do të kujdesem unë sikur me qenë djali i dytë për ty. Gjyshi im nuk shihte në atë kohë dhe i ka thënë Enveri që; do të çojë dikë, do të marr të operoj dhe ti do të shohësh. Ai e ka falenderu, ndërsa nëna i ka thënë: "Sna duhen më sytë!"

Po tek shtëpia juaj a ka ardhur Enver Hoxha?

Po vite më vonë ka ardh në shtëpi tek unë. Gjyshi nuk jetonte. Di që kur ka vdeq gjyshi, ishin ato shërbimet shtetërore, nuk e di. Kanë sjell në atë kohë, kafe, piçe. Enver Hoxha ka ardh në shtëpinë tonë, në '68-ën që ka kalu në disa zona në Mirditë dhe kur jam martu unë, në dasëm më ka sjellë të birin me nusen (Iirin dhe Teutën) dhe më ka bërë edhe një letër urimi dhe më ka dhuru një orë. Me Enver Hoxhën jam taku gjithashtu edhe në moshë të rritur, përveç '68-ës edhe një herë në Kongresin e 8- të Partisë. Ish Kryetari i Komitetit ktu atëherë, Gjon Deda, në një takim që kishte me Enverin, ai e pyeste vazhdimisht. I ka thënë që; unë nuk e kam pa prej kohësh Marijen dhe kam dëshirë me e taku. Më kanë marrë, më kanë çu me një makinë apostafat në Tiranë dhe kam qenë në mbrëmjen që është bërë në Pallatin e Brigadave, në mbyllje të Kon-



gresit. Aty pastaj më ka taku dhe ka thënë që; do marr një valle me Marijen. Kemi kërcy një valle popullore duke u thënë edhe delegacioneve që; kjo është goca e një shokut tim të luftës.

Po nëna juaj, lidhur me vrasjen e Bardhokut apo trajtimin që iu bëhej familjes suaj më pas, a ka pas shprehur ndonjëherë ndonjë pakënaqësi ndaj atij regjimi?

Nana nuk ka pas shprehur asnjëherë ndonjë pakënaqësi. **Mbas vitit 1991, janë kthyer në Shqipëri disa nga ata të Komitetit të Maleve që kanë qenë atë ditë me grupin që morën dhe vendimin për të vrarë Bardhok Bibën. A keni tentuar ndonjëherë të takoheshit me ta, apo ata me ju?**

Me kta që erdhën nga emigracioni...., po e zemë njëherë

me fisin tim, Ndue Pjetër Gjonmarkun, nuk jam taku dhe nuk kam dash me u taku. Ai ka ba pastaj një kërkesë, por nuk kam pas dëshirën, sepse unë kam dit mirfillt, se e kam pa me sytë e mi, letrën që ai kishte shkru për vrasjen.

Kur e keni parë atë letër dhe çfarë shkruhej në të?

Ka qenë atëhere Dega e Punëve të Brendshme, flas para viteve '90-të. Me një drejtues kam pas muhabet dhe më pat thënë që; ne kemi disa dokumenta që do i çojme me i dorzu. Në qofte se dëshiron, diçka mund të jap, por të mbetet vetëm ktu. E pashë....

Po pse u shkrua ajo letër që iu la mbi trupin e vrarë të babait tuaj?

Ndojës (Ndue Pjetër Gjonmarku) kanë thënë me bë letrën fisis, sepse kuptohej që ishin problem fisesh aty, dhe kanë qenë edhe Mëlysh, etj. Kanë thënë që; nuk e vrasim pa na dhënë një letër; sepse nesër kur të ndodhi ndonjë diçka, do të ngatërrohesh me ne, sepse e ke të fisit tënd. E ka ba atë letër. Me emrin dhe me firmën e vet.

Thatë që nuk keni dashur dhe nuk keni pranuar ta takonit Ndue Pjetër Gjonmarkun?

Ndue Pjetri ka pas kriju Komitetin e Maleve, më pat shkrujt diçka, që; unë nuk jam fajtor (bëhet fjalë për organizatën "Heroizma Shqiptare") që pati krijuar Ndue Pjetër Gjonmarkaj, e cila pati aktivitet edhe në Shqipëri pas vitit 1991 kur ai erdhi për herë të parë në atdhe nga emigracioni i gjatë. Shënimi ynë, D.K.). Ndue Gjonmarku më ka ba një letër pas '90ës dhe si Kryetar i Komitetit të Maleve, ku midis të tjerash më shkruante: "Ne kishim bindje të ndryshme, por nuk kam pas dëshirën me e vra Bardhokun". Më vonë e kam dëgju me veshet e mi, duke thënë: "Unë e kam vra Bardhok Bibën". Pas kësaj për mua ishin të preme të gjitha marrëdhëniet, ndërsa me pjesën tjetër të fisis, marrëdhëniet i kemi kriju veç në demokraci.

Ju personalisht, ku keni punuar para viteve '90-të

Mësuese kam punuar në Rrëshen dhe shumë vite në Komitetin e Partisë të Mirditës, fillimisht si instruktore dhe më pas edhe si sekretare komitete.

Ndërsa pas viteve '90-të jeni zgjedhur deputete e Mirditës në Parlamentin e parë dhe disa vjet më vonë edhe si kryetare e Bashkisë së Mirditës...?

Po, në '91-in jam zgjedhur deputete në Kuvend Popullor; atëherë nga Fronti. Kam qenë për zonën Rubik-Kaçan. Ndërsa në vitin 2000, për një mandat jam zgjedhur edhe kryetare e Bashkisë së Rrëshenit ku kam punuar me të gjitha energjitë e mija.

Zgjedhja në këto detyra e funksione tregon se Mirdita dhe mirditorët ju kanë respektuar edhe si e bija e Bardhok Bibës?

Po patjetër.... dhe më respektojnë mjaft dhe për këtë gjë u jam shumë mirënjohëse.



BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Tirana shpenzon më shumë se çdo qytet tjetër në Shqipëri

Familjet shqiptare harxhojnë më pak për ushqime e veshje

INSTAT: Konsumi i mallrave ra në vitin 2017

Konsumi i familjeve shqiptare për veshje dhe ushqime ka pësuar rënie gjatë vitit 2017. Sipas INSTAT shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF-ve, (Njësi familjare) të përbëra mesatarisht nga 3,7 persona, janë 73.400 lekë, raporton Monitor.

Totali i shpenzimeve për konsum është 56,5 miliardë lekë në muaj për 769.494 familje. Shpenzimet mesatare për konsum të një individi vlerësohen të jenë 19.660 lekë në muaj, nga të cilat: 8.664 lekë për konsum ushqimor dhe 10.996 lekë për konsum jo-ushqimor.

Vlerësimi i shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF-ve në vitin 2017, është 0,4 % më i lartë se në vitin 2016.

Rritja e çmimeve të konsumit, në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, është 2,0 %. Uljen më të madhe të shpenzimeve mesatare për konsum mujor, në vitin 2017, e ka shënuar grupi "Veshje dhe këpucë", me 11,4%, krahasuar me vitin 2016, ndërsa rritja më e madhe është regjistruar në grupin "Transport", me 14,9 %.

Shpenzimet e bëra në grupin "Transport" në vitin 2017 kanë pësuar rritjen më të lartë prej 14,9 %, krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i rritjes më të madhe të shpenzimeve për nëngrupin "karburante dhe lubrifikantë".


Shpenzimet e bëra në grupin "Shëndet" kanë shënuar rritje prej 14,3 %, krahasuar me vitin 2016, rritje e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve për nëngrupin "medikamente".

Shpenzimet e bëra në grupin "Restorante dhe hotele" kanë regjistruar një rritje prej 11,8 %, krahasuar me vitin e kaluar, rritje e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve të nëngrupit "restorante". Sa

Tab.1 Struktura e shpenzimeve të konsumit të NjEF, 2016 - 2017

Grupet kryesore të konsumit	ABF 2016		ABF 2017		Ndryshimi (%)
	Vlera në Lekë	%	Vlera në Lekë	%	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	33.083	45,2	32.347	44,1	-2,2
Pije alkoolike dhe duhan	2.507	3,4	2.558	3,5	2,1
Veshje dhe këpucë	3.532	4,8	3.128	4,3	-11,4
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	7.477	10,2	7.998	10,9	7,0
Mobilim, pajisje shëpieke dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	3.662	5,0	3.505	4,8	-4,3
Shëndet	2.519	3,4	2.879	3,9	14,3
Transport	4.609	6,3	5.294	7,2	14,9
Komunikim	2.392	3,3	2.479	3,4	3,6
Argëtim dhe kulturë	2.173	3,0	2.224	3,0	2,4
Arsim	3.207	4,4	2.868	3,9	-10,6
Restorante dhe hotele	3.253	4,4	3.638	5,0	11,8
Të tjera mallra dhe shërbime	4.729	6,5	4.480	6,1	-5,3
Shpenzimet mesatare gjithsej	73.143	100,0	73.400	100,0	0,4

Fig.1 Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF sipas qarqeve, 2017.



SHPENZIMET

Shpenzimet e bëra në grupin "Transport" në vitin 2017 kanë pësuar rritjen më të lartë prej 14,9 %, krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i rritjes më të madhe të shpenzimeve për nëngrupin "karburante dhe lubrifikantë". Shpenzimet e bëra në grupin "Shëndet" kanë shënuar rritje prej 14,3 %, krahasuar me vitin 2016, rritje e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve për nëngrupin "medikamente". Sa

STRUKTURA E SHPENZIMEVE MESATARE MUJORE

Grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike", me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 32.347 lekë, i cili zë një peshë prej 44,1 % në buxhetin familjar. Nëngrupet që zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë "qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë", me 18,1 %, "bukë dhe drithëra" dhe "mish dhe nënprodukte" mbi 17 %, ndjekur nga "perimet", me 13,7 % dhe "frutat" mbi 8 %.

dhe Shkodra, me 73.306 lekë në muaj për NjEF.

Qarqet me nivel më të ulët të shpenzimeve mesatare mujore për konsum janë qarku i Dibrës me 47.467 dhe i Elbasanit, me 57.831 lekë në muaj për NjEF. Rritjen më të madhe të shpenzimeve e paraqet qarku i Gjirokastrës me 9,1 %, ndjekur nga qarku i Beratit me 8,9 %. Qarku që ka pësuar uljen më të madhe të shpenzimeve për konsum është Dibra me 24,9 %. Në vitin 2017, numri mesatar i anëtarëve të NjEF është 3,7. qarku me numrin më të madh të anëtarëve të NjEF është Kukësi me 4,4 anëtarë, ndërsa Vlora është qarku me numrin më të vogël të anëtarëve në përbërjen e NjEF, me 3,3 anëtarë.

Të pasurit konsumojnë 3,4 herë më shumë se të varfrit

Konsumi për frymë i 90 % të NjEF-ve me shpenzimet më të ulta janë mesatarisht 18.311 lekë në muaj, ndërsa 10 % i NjEF-ve me shpenzimet më të larta janë mesatarisht 62.329 lekë në muaj për frymë. Raporti i decileve 10/90 është 3,4 herë më i madh, në favor të 10 % të NjEF-ve.

Shpenzimet mesatare për konsum të NjEF-ve tregojnë se në vitin 2017 ka pasur një ulje prej 4,3 % të shpenzimeve të 10 %-shit të NjEF-ve me shpenzimet më të larta dhe një rritje prej 1,7 % të shpenzimeve mesatare për konsum të 90 %-shit tjetër, në krahasim me vitin 2016. Si rrjedhim, raporti i decileve në 2017, për këtë tregues, paraqet një ulje të pabarazisë nga 2,5 në 2,4, krahasuar me 2016.

Shpërndarja e shpenzimeve mesatare të konsumit sipas tipit të NjEF, 2017.

Në 2017, NjEF-të e përbëra nga një person i vetëm, me fëmijë në varësi, shpenzojnë më shumë për ushqim, prej 47,1 %, krahasuar me tipet e tjera. Shpenzimet më të larta për transport paraqiten në NjEF-të e përbëra nga tri ose më shumë të rritur me fëmijë, me 8,2 %. Shpenzimet më të larta për arsim regjistrohen në NjEF-të e përbëra nga tri ose më shumë të rritur me dhe pa fëmijë në varësi.

vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 32.347 lekë, i cili zë një peshë prej 44,1 % në buxhetin familjar. Nëngrupet që zënë peshën më të madhe në shpenzimet për ushqim janë "qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë", me 18,1 %, "bukë dhe drithëra" dhe "mish dhe nënprodukte" mbi 17 %, ndjekur nga "perimet", me 13,7 % dhe "frutat" mbi 8 %.

Grupi i shpenzimeve për banesën, me shpenzimet për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira të paguar dhe riparime të vogla, me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 7.998 lekë, përbën 10,9 % të totalit të buxhetit familjar.

Grupi "Transport", me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 5.294 lekë, zë 7,2 % të buxhetit gjithsej. Peshën më të madhe brenda këtij grupi e përbëjnë "shpenzimet për karburante dhe lubrifikantë", me 57,8 %, ndjekur nga shpenzimet për "shërbim transporti", me 22,2 %.

Tirana me shpenzimet më të larta, Elbasani më të ultat

Në vitin 2017, qarku i Tiranës paraqet shpenzimet mesatare më të larta mujore për konsum. Një NjEF në qarkun e Tiranës shpenzon për konsum mesatarisht 87.968 lekë në muaj. Qarqet që paraqesin shpenzimet mesatare më të larta për konsum, pas qarkut të Tiranës, janë Durrësi me 76.129 lekë dhe

Vlerësimi i shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF-ve në vitin 2017, është 0,4 % më i lartë se në vitin 2016. Rritja e çmimeve të konsumit, në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, është 2,0 %. Uljen më të madhe të shpenzimeve mesatare për konsum mujor, në vitin 2017, e ka shënuar grupi "Veshje dhe këpucë", me 11,4%, krahasuar me vitin 2016, ndërsa rritja më e madhe është regjistruar në grupin "Transport", me 14,9 %.

i përket strukturës së shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF-ve, sipas 12 grupeve kryesore të konsumit, peshën më të madhe e zënë grupet:

Grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike", me një

Tab.1 Struktura e shpenzimeve të konsumit të NjEF, 2016 - 2017

Grupet kryesore të konsumit	ABF 2016		ABF 2017		Ndryshimi (%)
	Vlera në Lekë	%	Vlera në Lekë	%	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	33.083	45,2	32.347	44,1	-2,2
Pije alkoolike dhe duhan	2.507	3,4	2.558	3,5	2,1
Veshje dhe këpucë	3.532	4,8	3.128	4,3	-11,4
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	7.477	10,2	7.998	10,9	7,0
Mobilim, pajisje shëpieke dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	3.662	5,0	3.505	4,8	-4,3
Shëndet	2.519	3,4	2.879	3,9	14,3
Transport	4.609	6,3	5.294	7,2	14,9
Komunikim	2.392	3,3	2.479	3,4	3,6
Argëtim dhe kulturë	2.173	3,0	2.224	3,0	2,4
Arsim	3.207	4,4	2.868	3,9	-10,6
Restorante dhe hotele	3.253	4,4	3.638	5,0	11,8
Të tjera mallra dhe shërbime	4.729	6,5	4.480	6,1	-5,3
Shpenzimet mesatare gjithsej	73.143	100,0	73.400	100,0	0,4

Ditën e djeshme, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka dhënë dorëheqjen nga posti i tij. Mediat kosovare bëjnë me dije se ky vendim erdhi pasi ministri Tahiri nuk ka qenë i kënaqur me zhvillimet e fundit në sistemin e drejtësisë duke përfshirë këtu edhe ndërhyrjet politike. Sipas tij të gjitha këto pritet të ndikojnë në



Tërhiqet Abelard Tahiri, shkak pengimi i liberalizimit të vizave

Ndërhyrjet politike në drejtësi, dorëhiqet ministri i Drejtësisë në Kosovë

mosliberalizimin e vizave. Tahiri i ka ofruar dorëheqjen kryetarit të partisë dhe kryeministrit të vendit. Ofrimi i dorëheqjes vjen si pasojë e problemeve të fundit në sistemin e drejtësisë dhe ndërhyrjeve politike në të.

Megjithatë akoma nuk është konfirmuar pranimi i dorëheqjes së Tahirit. Ndërkohë që më herët, në muajin shkurt një tjetër ministër ka dhënë dorëheqjen nga posti. Ka qenë pikërisht ministria e

Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë, Albena Reshitaj, e cila ka thënë dorëheqjen. Sipas Reshitajt, arsyeja e këtij vendimi është personale. "Për shkaqe personale, sapo kam ofruar dorëheqjen time nga pozita

e ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor", - janë fjalët e Reshitajt, e cila shton se vullneti dhe përkushtimi i saj për t'i kontribuar vendit, mjedisit ku jeton dhe vepron, do të vazhdojë gjatë gjithë jetës së saj. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj e ka pranuar dorëheqjen e ministres, duke e falënderuar atë për bashkëpunimin e deritanishëm.

Presidenti serb shkon në Moskë, në delegacion është dhe Ivica Dačić

Sot takimi me Putin, Vuçiç: Do bisedojmë dhe për Kosovën

Hashim Thaçi viziton Veriun, Vuçiç: U kërcënua paqja

Aleksandar Vuçiç, presidenti i Serbisë, do të qëndrojë sot në vizitë pune në Moskë, bëri të ditur kabineti i tij. Në komunikatën që transmetojnë mediat serbe, thuhet se Vuçiç do të takohet me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin. Në delegacionin e Serbisë do të jetë edhe ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić. Vuçiç ka thënë më herët se do të kërkojë nga Putini mbështetje për Serbinë në të gjitha forumet ndërkombëtare, raporton 'rel'. "Do të kem takim me Putinin dhe do të bisedojmë për të gjitha çështjet e rëndësishme, natyrisht edhe për Kosovën", tha Vuçiç të shtunën. Ndërkaq ditën e diel, hyrjen e forcave speciale të Kosovës, ROSU, në veri të Kosovës, presidenti i Serbisë e cilësoi si sulm të armatosur banditësh. Sipas Vuçiç, me hyrjen e tyre në këtë territor u kërcënua paqja. "Operacioni përfshiu 110 deri në 130 anëtarë të forcave speciale të Kosovës, të gjithë shqiptarë, që kanë zënë rrugë hyrëse dhe të gjitha objektet pranë Ujmanit, duke keqtrajtuar brutalisht disa persona dhe duke mbajtur peng katër", tha Vuçiç për mediat serbe. Kujtojmë se njësitet speciale të Kosovës të shumta në numër në veri ishin për shkak të vizitës së presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe në vendkalimin kufitar Bërnjak dhe Liq-



Alekssander Vuçiç dhe Vladimir Putin

enin e Ujmanit. Thaçi pohoi se vizita e tij atje ishte "rutinore" dhe "krejt normale", por autoritetet në Serbi thanë se policia e Kosovës ka marrë nën

kontroll liqenin dhe hidrocentralin e Ujmanit dhe se ka arrestuar disa serbë. Vuçiç, në një fjalim drejtuar kombit serb, tha se me vizitën e Thaçit

u shkelën disa marrëveshje. "Nuk e di nëse kanë pasur pëlqimin e NATO-s, por kushti i dytë është shkelur plotësisht", - tha presidenti serb.

Ambasadori i SHBA: Nuk përkrahim çdo zgjidhje të marrëveshjes

Ambasadori amerikan në Beograd, Kyle Scott, ka deklaruar dje para gazetarëve në Beograd se SHBA-të janë të hapura për marrëveshje ndërmjet palës kosovare dhe asaj serbe. Megjithatë ai ka shtuar se kjo nuk do të thotë se Washingtoni do të përkrahë çfarëdo marrëveshje, shkruajnë mediat serbe. "Do të shqyrtojmë çdo zgjidhje, por kjo nuk do të thotë se do të përkrahim çdo zgjidhje, pasi që nuk e dimë se për çfarë po bisedohet", ka shtuar Scott në Beograd. Diplomati amerikan, gjithashtu, tha se zgjidhja e arritur nga palët e interesuara do të ishte zgjidhja më e mirë, dhe nëse një gjë e tillë arrihet mes Beogradit dhe Prishtinës, do të jetë e qëndrueshme. Kështu që ndërkombëtarët mbeten në pritje të një rezultati të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Cunam dhe tërmet në Indonezi, vdesin 1200 persona

Vijojnë katastrofat natyrore në vende të ndryshme të botës. Kësaj radhe, në Indonezi ajo që ka lënë pas egërsia e një cunami ka qenë baltë e madhe dhe ndërtesa plotësisht të shkatërruara. Pamjet e filmuara nga një dron tregojnë zonat e goditura nga tërmeti që pasoi me një cunami në ishullin e Sulawesi ku viktimat akoma në një bilanc jo definitiv, janë më mijëra. Personat e mbetur pa shtëpi janë 48 mijë, ka shpjeguar zëdhënësi i mbrojtjes civile indoneziane. Qytetet Palu dhe Dongala në Indonezi janë shndërruar në varre masive si pasojë e cunamit që gjunjëzoi mbarë vendin. Bilanci i viktimave nuk ka të ndalur. Aktualisht mbi 1200 trupa të pajetë janë gjetur nën rrënojat e ndërtesave, por shifra përfundimtare për fat të keq pritet të jetë edhe më e lartë. Ekipe të emergjencave vijojnë ende kërkimet për gjetjen e të mbijetuarve nën gërmadha. Krahas tragjedisë së humbjes së njerëzve, një tjetër rrezik që u kanoset të mbijetuarve është ai i përhapjes së epidemive. Edhe më të vështirë punën e ekipeve të shpëtimitit e bën mungesa e pajisjeve moderne dhe dëmtimi i rrjetit të komunikimit. Autoritetet indoneziane kërkuar ndihmë nga organizatat ndërkombëtare, pasi misioni për forcat vendase është i pamundur. Tërmeti i fuqishëm 7.5 ballë që goditi të shtunën Indonezinë shkaktoi dallgë gjigante që shkuan deri në 6 metra lartësi që shkatërroi qindra ndërtesa. Bëhet fjalë për katastrofën më të madhe që prej asaj të vitit 2004, kur një cunami shkaktoi 120 mijë viktime në Indonezi.



REFERENDUMI NDARJA

Ziadin Sela: Pjesëmarrja e ulët, indignatë ndaj kimit e korrupsionit qeveritar

Pjesëmarrja e ulët e votuesve në referendumin e ditës së diel nuk la pa tërhequr vëmendjen e Ziadin Selës. Kreu i "Aleancës për Shqiptarët" mendon se një faktor i rëndësishëm në rezultatit e referendimit të Maqedonisë ishte lishin listat zgjedhore, që si-

pas tij, nuk u pastruan nga votuesit fiktivë. Ai komenton se, "ky nivel pjesëmarrjeje ishte edhe një zë indignate kundër kimit e korrupsionit qeveritar". Sela vlerëson se shqiptarët dolën në votime thuasje në të njëjtën masë sa në zgjedhjet vendore e politike.



Ali Ahmeti: Zgjedhjet e parakohshme s'janë zgjidhja

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti tregoi se zgjedhjet e parakohshme nuk janë një opion për të dhe u dërgoi tërthorazi mesazhin deputetëve se çfarë përgjegjësie rëndon mbi ta për të marrë vendimin e

duhur. "Ne jemi të zgjedhur që të marrim vendime të rëndësishme, të guximshme e jo të përlogarimis zgjedhjet e ardhshme. Por edhe të kujdesemi për të ardhmen e rajonit dhe të Europës Juglindore", tha Ahmeti.



SHBA mbështet Marrëveshjen e Prespës, ja mesazhi ndaj politikanëve

Votimi i qytetarëve në referendumin e së dielës rezultoi i dështuar, edhe pse të shumta ishin reagimet pozitive lidhur me rezultatit e këtij procesi. Ndër to nuk ka munguar as reagimi i ndërkombëtarëve, ku Departamenti Amerikan i Shtetit, përmes një deklarate apeloj partitë në Maqedoni të ngrihen mbi politikën partiake dhe të shfrytëzojnë këtë mundësi historike. "SHBA-të e mbështesin fuqishëm implementimin e plotë të Marrëveshjes së Prespës, e cila i mundëson Maqedonisë të marrë vendin e merituar në NATO dhe BE dhe do të kontribuojë në stabilitetin rajonal, të sigurisë dhe prosperitetit. Kuvendi i Maqedonisë tani fillon me shqyrtimin e ndryshimeve kushtetuese, ndaj i ftojme liderët të ngrihen mbi politikën partiake dhe të shfrytëzojnë këtë mundësi historike që të mundësojnë të ardhme të ndritur për vendin si anëtare e plotfuqishme e institucioneve perëndimore", - thuhet në deklaratën e DASH. Ndërkohë që nga ana tjetër ka reaguar edhe ministri i Jashtëm i Maqedonisë, i cili e ka quajtur këtë proces si të suksesshëm. Nikola Dimitrov tha se referendumi i së dielës në këtë vend doli i suksesshëm, sepse siç u shpreh, për marrëveshjen me Greqinë për çështjen e emrit votuan mbi 600 mijë qytetarë. Ai i bëri këto komente edhe pse pjesëmarrja në referendum nuk e kaloi pragun e nevojshëm prej mbi 50%. "Nëse nga mbi 650 mijë qytetarë që dolën në referendum, mbi 600 mijë kanë votuar 'pro', ky është mandati i qartë politik që Maqedonia të ecë para. Fitore më e madhe nga cilado fitore e ndonjë partie politike", tha Dimitrov në një postim në "Facebook", njëfon REL. Ai tha se tani mbetet të dëgjohet vullneti i popullit nga ana e deputetëve në Kuvend. "Ua kemi borxh qytetarëve të ardhmen dhe do ta sigurojmë në një mënyrë, ose tjetër", tha Dimitrov. Ai është njëri nga nënshkruesit e marrëveshjes me Greqinë

Referendumi në Maqedoni, DASH: Kuvendi të shqyrtojë ndryshimet kushtetuese

Nikola Dimitrov: Fitore e madhe, borxh qytetarëve



Departamenti i Shtetit

DASH
"SHBA-të e mbështesin fuqishëm implementimin e plotë të Marrëveshjes së Prespës, e cila i mundëson Maqedonisë të marrë vendin e merituar në NATO dhe BE dhe do të kontribuojë në stabilitetin rajonal, të sigurisë dhe prosperitetit. Kuvendi i Maqedonisë tani fillon me shqyrtimin e ndryshimeve kushtetuese", - thuhet në deklaratën e DASH.

Zaev: S'jap dorëheqjen, do e çoj procesin përpara

Zoran Zaev, kryeministri i Maqedonisë, në konferencën pas referendimit për emrin e Maqedonisë deklaroi se nuk ka ndër mend të dorëhiqet. Ai tha se vota pro e qytetarëve e detyron atë që procesin ta kalojë në procedurë parlamentare dhe në rast se nuk siguron 2/3 e votave, nuk përjashton mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme, që sipas Zaevit, fundi i nëntorit do të ishte datë e përkryer. "Radhën e ka parlamenti, dhjetë ditë do të bëjmë përpjekje, por në rast se nuk arrijmë të sigurojmë 2/3 e votave, atëherë alternativë mbeten zgjedhjet e parakohshme", deklaroi Zaev. Pas referendimit ka dy opsione, siç paralajmëroi kryeministri Zaev, për implementimin e Marrëveshjes me Greqinë. I pari është miratimi i ndryshimeve kushtetuese në parlament, për çka do të duhet të votojnë edhe deputetët e VMRO-DPMNE-së dhe opioni i dytë janë zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Vijon numërimi i votave, përfundojnë 98,61% e kutive

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Maqedoni ka publikuar ditën e djeshme rezultatet e votave të numëruara nga referendumi për marrëveshjen e emrit me Greqinë. Nga 98,61% të vendotime të numëruara rezultoi se 91,48% për qind e votuesve janë shprehur "pro" pyetjes "a jeni për anëtarësim në BE dhe NATO me pranimin e marrëveshjes së Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë". Ndërkohë 5,64% janë shprehur kundër marrëveshjes. Pjesëmarrja në votime ka qenë 36,87%, ose e thënë ndryshe kanë votuar 661.319 qytetarë të Maqedonisë. Sipas ligjit, mbi 450 mijë qytetarë duhet të votojnë pro që referendumi të kalojë. Mirëpo që ky proces të konsiderohet i ligjshëm duhet të kalohet pragu, çka do të thotë se duhet të marrin pjesë në votim mbi 900 mijë qytetarë. 1,8 milionë qytetarë kishin të drejtë vote për të pranuar emrin Maqedonia e Veriut, në mënyrë që vendit t'i hapet rruga drejt anëtarësimit në NATO dhe BE, ose të refuzojnë marrëveshjen duke votuar kundër.

Kukan: Referendumi sinjal pozitiv, politika të ecë përpara

Vetëm një ditë pas referendimit për emrin e Maqedonisë, i cili rezultoi i dështuar për shkak të pjesëmarrjes së ulët të qytetarëve, ka ardhur reagimi nga eurodeputeti dhe anëtari i Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian, Eduard Kukan. Përmes një postimi në "Twitter", Kukan nënvizoi faktin se duhet të kuptohet sinjali pozitiv i referendimit nga politika. "Sinjali pozitiv i këtij referendumi duhet të kuptohet nga politika. Të shfrytëzojnë mundësinë për të ecur për-



para, për një të ardhme më të mirë të Maqedonisë", tha në reagimin e tij Kukan. Ndërkohë që sipas analistëve, tani beteja do të zhvillohet në parlament. Kryeministri Zaev do të duhet të sigurojë shumicën e nevojshme parlamentare për kalimin e ndryshimeve kushtetuese, konform marrëveshjes me Greqinë për ndërrimin e emrit të vendit në Republika e Maqedonisë së Veriut, ose në të kundërtën, zgjedhjet e jashtëzakonshme janë të paevitueshme. Në debatin e zhvilluar në "Studion e Hapur" në "Klan", Maqedoni, është folur për zhvillimet e pritshme pas ditës së djeshme. Analistët nuk përjashtojnë mundësinë e një krize të re politike.

për ndryshimin e emrit të shtetit të tij në Maqedonia e Veriut. Miratimi i kësaj marrëveshjeje në referendum dhe

me ndryshimet e nevojshme kushtetuese është thënë se do t'i hapte rrugën anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe

në Bashkimin Evropian. Të dielën, qytetarët e Maqedonisë votuan nëse janë në favor të anëtarësimit të vendit të

tyre në këto organizata përmes zbatimit të marrëveshjes për emrin.

FESTIVALI I TEATROVE

NDRIÇIM XHEPA:

Shfaqjet nuk meritonin ditirambe, kishte tri cilësi

Fatmira Nikolli

Reshat Arbana, Luiza Xhuvani, Altin Basha, Dino Mustafiç, Kristian Koroveshi, Shkëlzen Veseli etj., janë fituesit e mëdhenj në Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrove mbajtur në Tiranë në datat 23-30 shtator. Mes 'arTurbinës' dhe sallës së Universitetit të Arteve 14 shfaqjet u ndoqën për tetë ditë rresht dhe në fund u vlerësuan nga një juri e përbërë nga Ndriçim Xhepa, (kryetar jurie) dhe anëtar Josif Papagjoni, Shkumbin Istrefi, Luli Bitri dhe Qëndrim Rijani.

Të dielën, drejtori i Teatrit Kombëtar që është vendosur në 'arTurbinë', Hervin Çuli, i shprehu dëshirën ministres së Kulturës, e pranishme në sallë, që këtë festival ta kthejë të përvitshëm megjithëse në një javë është diskutuar se cilësia e prurjeve që mesatare e mediokre në të gjithë elementët. Megjithëse kritika mungon, edhe kur është trembet lehtë nga reagimi i artistëve që refuzojnë të pranojnë gjykimin për atë që bëjnë. Edhe ky festival, vetëm sa u përpoq të vërë një gur themeli mbi kritikën e munguar, por pa ia dalë të krijojë një farë tradite e madje as ta nxisë atë. Ndaj ndodhte, që shfaqjet që nuk kishin interpretim të vlerësoshëm për regjinë, e shfaqjet që s'kishin regjinë të vlerësoshëm për interpretimin, pa ia dalë të thuhej për secilin ato që evidentoheshin e ato që mungonin. Parë në këtë prizëm, festivali arriti t'i mbledhë të gjithë të shihnin njëri-tjetrin, por nuk arriti që njëri-tjetri t'i thoshin shohoqit ku qëndronin mangësitë.

Ditën e diel kritikë Josif Papagjoni, në cilësinë e anëtarit të jurisë tha: "Është një problem i madh në të gjithë hapësirën tonë organizimi i mendimit kritik për shfaqjet. Mirë lavdërimi pa fund, por duam edhe tre gjëra. Mua më duket se kjo është më shumë një deklaratë, se kur vjen mendimi për të thënë tri gjëra nis shërri". Sipas tij, duhet të ftojë ata që i paguajmë që rrinë në kafe edhe në hotele të flasim për të gjithë komponentët. "Sidomos të gjejmë një mënyrë të tillë që jo të lazojmë, por oponenta. Mirë do të ishte që të ishte një tavolinë debati, dua që të parashtrij në këtë diskutim edhe nevojën për diskutime estetike... Ka shumë probleme që mundet që t'i trajtojmë në një tavolinë tjetër. A vijmë? A kemi dëshirë që të dëgjojmë njëri-tjetrin? Unë shikoj se vëmendja ka ikur,



Hervin Çuli dhe Ndriçim Xhepa

indiferenca është totale. Njerëzit janë limontin dhe shpesh i mbulon meskiniteti, nuk kanë dëshirë për përpëllitje edhe përpjekje intelektuale. Nuk e di se si mundet që të diskutohet në bashkësi të tilla artistësh, që gjithmonë edhe më shumë po shkojnë drejt meskinitetit intelektual", u shpreh Papagjoni. Ndërkaq, të hënën Xhepa u përgjigjet pyetjeve për festivalin e cilësinë, si kryetar i jurisë.

CILËSIA E TË 14-AVE

Për kryetarin e jurisë, Ndriçim Xhepa, përgjigja për cilësinë është relative. "Normale është që të gjykojmë që nuk ka arsye që të jetë i shkëlqyeshëm, vezullues dhe të thurim ditirambe të paarsyeshme. Është festival që e para absolutisht shumë mirë që u bë, dhe që do të jetë më mirë të ketë vazhdimësi. Do të kishte edhe problemet e veta, sepse festivali, siç e pohoi edhe organizatori, drejtori i Teatrit Kombëtar, që i ka munguar selektori dhe secili teatër ka sjellë gjënë më cilësore. Por për të hyrë dhe konkurruar brenda një kompeticioni, ajo më cilësoria mbetet e diskutueshme". Ai i ndan shfaqjet në tri kategori. "Festivali ka edhe gjërat e mira të vetat. Ka edhe vepra mesatare dhe të dobëta për hir të së vërtetës. Në 14 premiera që u panë në këtë festival, unë mund të them 4 a 5 premiera që ishin me vlerë, me dinjitet, mund të kishte dy a tri premiera, që ishin mirë po themi, por ishin edhe 4 a pesë shfaqje që llinin shumë për të dëshiruar", thotë ai.

KONCEPTE, APO VËNIE NË SKENË

Kur e pyet për këtë, Xhepa, i ndan. "Unë them se kishte edhe koncepte regjisoriale, koncepte të qenësishme dhe të prekshe. Kemi veprën fituese të Shkupit, që nuk mund të them se nuk kishte koncept. Ai (Dino Mustafiç) është regjisor që ngacmon, që provokon,

Kryetari i jurisë bën "gjykimin final" dhe jep këshillat për festivalet e ardhshme



Regjisori Altin Basha

të tillë e ka fantazinë e tij në vëniet në skenë. Ai merr edhe vepra super të njohura, fillon ngacmon dhe e sjell në aktualitetin e sotëm. Dikundi ka gjëra që me të vërtetë i sheh dhe të pëlqejnë në teatër". Kishte më tej në festival, edhe gjëra që janë të diskutueshme. "Kemi Altin Bashën tek shfaqja e teatrit 'Migjeni', që me një vepër modeste të shkruar kaq e kaq dhjetëvjeçarë përpara siç është 'Gomari i Babatasit' e merr bashkëpunon me Stefan Çapalikon, hyjnë e mbushin dhe e plotësojnë dhe e sjellin më afër duke provokuar e ngacmuar", thotë ai. Shton se mund të vazhdojmë me Teatrin e Prizrenit, me Kushtrim Bekteshin, që edhe ai kishte një vepër të tijen, por edhe regjisorë që la përshtypje të mira. "Kemi Teatrin e Prishtinës me 'Kaligulën', e cila që një regji që e shihja për herë të parë me një vend të veçantë. Do të fusja në këtë kuadër edhe veprën e teatrit të 'Metropolit', ku regjisorja Armela Demaj solli një vepër të punuar me shumë finesë e me shumë pasion", tha Xhepa. Për aktorin e njohur, njëherësh kryetar jurie, trupat e rretheve, pavarësisht se rrethe të cilësisë së parë, siç janë Shkodra, Korça, Fieri, Elbasani, Durrësi, Vlora, natyrisht kanë një lloj përpjekjeje e një lloj dëshirë që shkon deri në një farë mase, sepse edhe investimet në njerëz, personel, aktorë është i limituar dhe ndaj mundësitë për të prodhuar spektakle të një niveli siç prodhojnë kryeqendrat, në këtë rast, Shkupi, Prishtina dhe Tirana siç po flasim, janë më të vogla. "Natyrisht, edhe kjo reflektohet edhe në cilësinë e shfaqjeve, për hir të së vërtetës. Me

keqardhje, e kam të vështirë ta pohoj, trupa jonë e teatrit, pjesë e së cilës jam, në këtë rast nuk mendoj se në mund të ishim në të njëjtin nivel me trupën e Prishtinës në këtë rast dhe të Shkupit, duke marrë vetëm tri kryeqendrat", tha Xhepa.

PJESË SHQIPTARE E TË HUAJA

Duke qenë se pati luhatje mes pjesëve shqiptare dhe atyre të huaja, Xhepa thotë se veprave të nivelit të parë botëror që vihen në të gjithë botën, duhet t'u japim përparësi tjetër. "Ndoshta edicioni tjetër që do bëhet më pastaj të jetë vetëm me dramaturgj të huaj dhe edicioni që vjen pas tij them se duhet të jetë vetëm me dramaturgj shqiptare. Mendoj se kjo do t'u japë përparësi dramaturgëve që do të kenë arsye të shkruajnë dhe regjisorët do të kenë arsye të gjejnë një vepër të mirë kombëtare, sepse do të vënë në teatër", thotë Xhepa para mediave. Sipas tij, aty do të ketë një ballafaqim të mirë mbi dramaturgjinë, mbi regjisorin shqiptar dhe mbi aktorin shqiptar për vepra me karaktere shqiptare. Them se mund të jetë më e logjishme e më e arsyeshme në këtë formë.

AKTORË APO INTERPRETUES

Për Xhepën është normale që të ketë ulje-ngritje cilësie. "Është normale të jetë kjo, se nëse do ishin të gjitha rolet e mira, të cilësisë ekselente atëherë edhe juritë do ta kishin shumë herë më të vështirë. Ka role të para, ka role të dyta, ka jo protagonistë e role të treta e plotësues. Edhe në këtë festival kishte role të mira, e krijime karakteresh

që u pasqyruan me shumë dëshirë të mirë, me singleritet dhe me gjykim të ndershëm kolegësh. Të gjitha ato personazhe që u futën në ato kuadratin e vogël të nominimit them se janë karaktere të arritura, role të mira". Ai veçon disa, "për shembull, në karakterin e rolit të dytë jo protagonist pa frikë mund të shtojë 6-7 aktorë. Ishin tre a katër aktorë të Prishtinës, pos atij që e fitoi, po ashtu 2-3 aktorë të Shkodrës, po kishte aktorë të mirë Prizreni, por edhe tre aktorë Shkupi me 'Vdekjen e Dantonit'.

NIVELI I TEATRIT

Kjo për të është një çështje ku duhet të ndalemi gjatë. "Kjo kërkim zbrëthim. Teatri ka probleme pa diskutim, por kjo nuk do të thotë që këto aktivitetet të mos kryhen. Për mendimin tim, teatri do të fillojë të tregojë avanca të dukshme në qoftë se ne do të mendojmë shumë seriozisht, po tepër seriozisht për regjisorin. Fatkeqësisht ne vërtetë kemi shkollë regjisure, në Akademinë tonë të Arteve, po atje duhet të ketë një tjetër proces që të paktën ata studentë që hyjnë në shkollën e regjisorit, brenda një kursi mund të evidentohen dy a tre elementë që në harkun e tri viteve nxjerrin kokën mbi ujë, në sensin e fantazisë e vlerës që reflektojnë dhe më pas për mendimin tim, ata individë duhet patjetër të shkojnë në një shkollë në fakultete me përvojë të tilla jashtë dhe Evropa ka shumë të tilla dhe jam i bindur që do të vijmë me tjetër bagazh, me tjetër strukturë profesionale, të cilën do ta reflektojnë në trupat përkatëse dhe as vetë ne nuk do ta kuptojmë sesi gradualisht, niveli i spektakleve dhe për inerci dhe niveli i festivaletve mbarëkombëtare do të jetë më tjetër vlerë", thotë Xhepa.

DITËT EUROPIANE TË TRASHËGIMISË



Viti 1989 rumunë në Shqipëri

Viti 1989 nisi pa asgjë të veçantë. Rutina e një dite të zakonshme ishte e njëjtë për dekada dhe miliona rumunë ishin pajtuar me të, në një simbiozë të plotë të përditshme. Në njërin anë kishte marshime festive kolektive dhe spektakle dedikuar lëvizjes komuniste, fjalime dhe seanca ideologjike, plane pesëvjeçare të realizuara në katër apo tre vjet. Nga ana tjetër, njerëzit jetonin në një gjendje varfërie progresive, me sende ushqimore që ktheheshin në mite, me spitale që, pa pajisjet dhe teknologjinë e duhur, shpesh përdoreshin për trajtimin empirik të pacientëve, me shkolla dhe miliona banesa që nuk kishin ngrohje në dimër ose ishin periodikisht pa ndriçim.

Rumunët jetonin në një robëri të plotë terrori. Vjesh-ta e vitit 1989 shënoi shen-

jat e para të ndryshimit, por ato nuk ofruan shpresë të menjëhershme për çlirim, veçanërisht pasi Nikolae Çausheku kishte përgatitur rizgjedhjen e tij si Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste rumune gjatë Kongresit të 14-të të Partisë, të zhvilluar në nëntor 1989.

Çlirimi erdhi papritur, me mosbindjen civile në Timisoara në sfond dhe me transformimin në kryengritje të një tubimi propagandistik në Bukuresht, që ishte planifikuar në mes të dhjetorit 1989 për të mbështetur ideologjinë e Partisë Komuniste. Për disa ditë, koha mbeti pezull në histori dhe një gëzim i plotë, një qetësi e pakrahasueshme çlirimi nga një robëri që dukej e pamshangshme, filloi të ndihej.

Fotografitë e ekspozitës janë përzgjedhur për të ilus-

Ekspozitë fotografike në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"

truar realitetin e vitit 1989, që nga rutina e jetës së përditshme komuniste deri në shpërthimin e gëzimit që përjetuan rumunët në fund të po atij viti.

Ajo që bie në sy në këtë ekspozitë është ngjashmëria e fotove dhe e realiteteve të asaj periudhe mes dy vendeve: arkitektura e billoqeve të reja të banimit, fotot propagandistike të dyqaneve të mbushura plot me produkte dhe me foton e diktatorit për të treguar "bollëkun" që i kishin sjellë popullit socializmi, mbledhjet e stafit me grafikët e planeve pesëvjeçare, tabelat e emulacionit dhe të fletërufëve, veshjet dhe shprehja e emocioneve të gëzimit përzjer me frikën ende të pranishme.

Historia që përjetoi Shqipëria për rreth 45 vjet nuk ishte shumë e ndryshme nga ajo që përjetuan Rumania dhe vendet e tjera të bllokut komunist, të cilat përmes represionit të paprecedent dhe kultit të individit ishin shkak i mbi 100 milionë viktimave.

Shqipëria dhe Rumania pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore krijuan sisteme politike të modeluara në BRSS. Të dyja vendet përjetuan themelimin e Partive Komuniste dhe krijimin e regjimeve komuniste, të cilat më vonë do të rezultojn të ishin më të ashpërja u vetëm në rajon, por edhe në një shkallë më të gjërë.

Brenda 1 muaji, gjatë vitit 1989 në Rumani ndodhi transformimi i madh politik.

Ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Lindore, ai ishte i përgjakshëm dhe i dhunshëm. Fotot me tanke e me të vrarë anës rrugëve të Bukureshtit janë mbresëlënëse.

Por 1989-a rumune ishte vit i rëndësishëm edhe për Shqipërinë. Ngjarjet e Timisoarës e të Bukureshtit ndikuan fuqishëm në Shqipëri. Ishte rënia në mënyrë të dhunshme e regjimit komunist në Rumani dhe fundi tragjik i Çausheikut, që e tronditën thellë regjimin komunist shqiptar. Qeveria shqiptare e asaj kohe, duke pasur informacion rreth situatës në Rumani, u ballafaqua ndryshe dhe i menaxhoi ndryshe protestat studentore të viteve 1990-1991, duke hyrë në dialog dhe duke bërë lëshime për të shmangur një

përfundim të ngjashëm brutal.

Kjo ekspozitë me autor Dr. Adrian Majuru vjen në vazhdim të bashkëpunimit midis Muzeve të Bashkisë së Bukureshtit dhe Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe", i cili filloi në pranverën e vitit 2018 përmes ekspozitës: "Albania's Road of Communism" mbi regjimin komunist në Shqipëri, të hapur në Bukuresht, në Pallatin Suçu, nga Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe". Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 30 nëntor 2018.

(Shkrimi i mësipërm është bazuar mbi të dhënat dhe përshkrimin që i është bërë ekspozitës nga Dr. Adrian Majuru - Drejtor i Përgjithshëm i Muzeve të Bashkisë të Bukureshtit dhe Etleva Demollari - Drejtore e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe")

MATTEO MANDALA: REFORMA NË SHKENCË DUHET TË JETË RRËNJËSORE

A nëtari i nderit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, arbëreshi Matteo Mandala është i mendimit se reforma duhet të jetë rrënjësore, në të mirë të kërkimit shkencor dhe mirëfunksionimit të institucioneve që e prodhojnë shkencën, që në të vërtetë janë njerëzit e shkencës. "Duhet me patjetër një reformë rrënjësore, por më përpara se të jetë në institucion duhet të jetë një reformë. Një revolucion kopernikan në kulturën e individëve. Duhet kuptuar që të jetosh në një botë aq të ndërlikuar dhe të përballshme me sfida të mëdha që vijnë nga bota duhet të jesh i përgatitur", shprehet Mandala për "ABC News". Debatit është gjithnjë i mirë për Mandalanë, por ai thotë se të jesh kundër, do të thotë që ti e ke një zgjidhje, në të

kundërt je i pabesueshëm ndaj kauzave që ngre. "Më parë se të flasësh, duhet të kesh përgjigjen, zgjidhjen gati sepse një në mjeshtrit e mi që pata në universitetin e Pisasë më tha një ditë dëgjo biri i mi, kur një problem quhet problem domethënë që ka një zgjidhje, kur problemi nuk ka zgjidhje, quhet tragedji", thotë ai. Ndërkohë që fjalimin e kryeministrit Edi Rama e krahasoi me shungullimën e De Radës. "Sepse angazhimi e tij ka qenë si shungullima e De Radës, që domethënë një tërmet që na ka dhënë mundësinë të kuptojmë që jemi në fund dhe shumë afër honit. Rreziku që të biem në hon, në ferr mund të jetë shumangur që në vetëreformohemi", thekson albanologu i njohur. Mendimi më i mirë sipas profesor Mandalas është ai i dalë nga grupi i punës i udhëhequr nga Skënder

Gjinushi, por ai pranon se duhen parë edhe vërejtjet e akademikut Artan Fuga. "Unë kam ndjekur grupin e punës të drejtuar nga Skënder Gjinushi. Dua të falënderoj dhe Artan Fugën për punën e tij dhe theksoj që debatet që zhvillohen midis dy të shurdhër duhet të jenë të ballafaqur në mënyrë demokratike, të hapur dhe duke i njohur tjetrit të drejtën e fjalës. Po duhet që të gjithë të jenë në gjendje të kuptojnë se ku e ka më të mirë tjetri dhe të gjejnë një kompromis", shprehet Mandala. Tkur-rjes së elitave dhe mendimit shkencor në kohët moderne, Mandala i jep këtë shpjegim. "Elita në shkencë krijohen me sakrificë, me flujime, me studime, me botime dhe me kërkime shkencore dhe kjo nuk varet vetëm nga intelektualitë dhe studiuesit, varet dhe nga sistemi", thekson ai.

KLITI KALLAMATA: SIMBOLIKAT E IKONËS QË IU DHURUA UNESCO-S

Pas dhuratës që qeveria shqiptare i bëri UNESCO-s, restauratori Kliti Kallamata ka bërë një shpjegim të simbolikave të ikonës, si më poshtë.



Qeveria shqiptare i dhuron UNESCO-s ikonën "Ringallja e Lazarit" nga Krishti. Duke qenë një dhuratë diplomatike cilat janë simbolikat esaj? Lazarit i Betanasi, i njohur si Shën Lazarit (Heb. Eleazari = "Perëndia është ndihma ime") është subjekti i një mrekullie të njohur të Jezu Krishtit, e cila përshkruhet në kapitullin 11-të të Ungjillit të Gjonit, ku Jezusi me fuqinë e Perëndisë e ringjalli atë në jetë katër ditë pas vdekjes së tij. Simbolikat e kësaj ngjarjeje janë disa, por ne nuk e dimë se cilën prej tyre ka zgjedhur stafi i protokollit që qeverisë për këtë dhuratë që i bëhet UNESCO-s? Le ti shohim me radhë:

Simbolika 1 - Ringallja e Lazarit ilustron fuqinë e

Jezu Krishtit mbi armikun më të papërmbyshëm të njerëzimit - vdekjen. Simbolizon Mrekullinë e Ringalljes - Mrekullinë e Rilindjes?! Po Jezu Krishti perëndi kush është?!

Simbolika 2. Mrekullia e Ringalljes së Lazarit përbën gjithashtu pikën kulmore të "shenjave" të Gjonit, të cilat i paraprijnë vendimit të Kajifas dhe Sanhedrit për të vrarë Jezusin. (Shenjë për kë? Nuk e besoj.)

Simbolika 3. Traditit

Ortodokse dhe Katolike japin pasqyrim të ndryshme të ngjarjeve të mëvonshme të jetës së Lazarit. Ai je një varr në Bethany të Jerusalemit, një tjetër në Larnaka të Qipros, ku thuhet se ai shërbeu si peshkop mbas ringalljes dhe ku vdiq për të dytën herë dhe një në Autun të Francës, pasi thuhet se shërbeu si peshkop i Marsejës, mbas largimit të tij nga Jerusalemi. (Lazarit simbolizon një njeri që ka vdekur dy herë dhe që ka tre varre?! Kush?)

Simbolika 4. Sipas traditës, gjithashtu Lazarit nuk buzëqeshi kurrë gjatë tridhjetë vjetëve pas ringalljes së tij, i shoqësuar nga sytë e shpirttrave me mëkatë të pashlyera që ai pa gjatë qëndrimit të tij katërditor në Hades. Përjashtim ka qenë vetëm një rast, kur ai pa se dikush kish vdekur një poçe dhe ai me buzëqeshje tha: "balta po vjedh baltën." (të jetë kjo?)

Dje në "Deutsche Welle"

Dështimi i referendumit në Maqedoni një mësim i hidhur

Nga Adelheid Feilcke

(vijon nga faqja 1)

... në Maqedoni, si rrjedhojë e një pjesëmarrjeje shumë të ulët, është një mësim i hidhur për shumë palë: për qeverinë në Shkup, për qeverinë në Athinë, për mbështetësit në BE dhe në NATO dhe për rajonin. Edhe pse referendumi jo detyrues nuk kishte ndonjë peshë të veçantë, prej tij varej diçka e madhe: bëhej fjalë për emërtimin e ri të shtetit të Ballkanit, për pajtimin me Greqinë dhe kësaj për anëtarësimin në NATO dhe në BE, shkurt pra për të ardhmen e republikës së vogël në bashkësinë e shteteve dhe të vlerave europiane dhe perëndimore.

Ende këto nuk janë humbur, por rezultati i referendumit pasqyron atmosferën në popull, gjë që të fut në mendime. Edhe pse tani shumë përpiqen ta zbkurojnë situatën, për faktin se 90 përqind e votuesve u shprehën pro, shumica e madhe në vend heshti dhe bojkotoi në mënyrë aktive. E kësaj mungon miratimi i gjerë i shpresuar për një proces, që në referendum kishte ndërlikuar qartazi tri çështje të së ardhmes: Marrëveshja me Greqinë. Integrimi në BE dhe në NATO. Ndaj dështimi i referendumit është edhe një sinjal paralajmërues jo vetëm për zhvillimet në vend, por edhe për orientimin e ardhshëm gjeopolitik të Ballkanit.

Pavarësisht mbështetjes masive nga politikanë të nivelit të lartë si Kancelarja Merkel, presidenti i Këshillit të BE-së Kurz, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg, kryeministri Zoran Zaev dhe qeveria e tij gjatë javëve të fundit nuk ia arritën ta mobilizojnë sa duhet popullin dhe ta bindin atë për avantazhet e marrëveshjes. Mjaft emocionale dhe rigorozë është rezistenca e kundërshtarëve, të cilët donin pjesërisht të ndëshkonin qeverinë dhe pjesërisht të mos pranin emrin Maqedonia e Veriut. Bojkoti masiv i referendumit tregon përçarjen politike të shoqërisë maqedonase dhe një pasiguri të madhe lidhur me çështjen e identitetit kombëtar dhe atij evropian: Llogaria se ndjenjat kombëtare do të pakësoheshin në favor të një perspektive europiane, nuk doli. Përkundrazi: konfrontimi edhe më emocional për çështjen e emrit stilizohet si temë e kombit dhe identitetit maqedonas.

Tani po shpaguehen dekadat e humbura, gjatë të cilave brenda vendit dhe në nivel ndërkombëtar është bërë shumë pak për ta



zgjidhur grindjen mes Greqisë dhe Maqedonisë për emrin e Maqedonisë dhe trashëgiminë e perandorisë antike. Këmbëngul-

ja, frika dhe plagët në Shkup janë të thella. Euforia e deritanishme për BE-në dhe NATO-n tani po vishet prej dyshimit.

Ende këto nuk janë humbur, por rezultati i referendumit pasqyron atmosferën në popull, gjë që të fut në mendime. Edhe pse tani shumë përpiqen ta zbkurojnë situatën, për faktin se 90 përqind e votuesve u shprehën pro, shumica e madhe në vend heshti dhe bojkotoi në mënyrë aktive. E kësaj mungon miratimi i gjerë i shpresuar për një proces, që në referendum kishte ndërlikuar qartazi tri çështje të së ardhmes: Marrëveshja me Greqinë. Integrimi në BE dhe në NATO.

Edhe nëse frikërat prej influencës ruse nuk u vërtetuan në referendum, narrativa antiperëndimore po zgjerohet. Lufta për kokat në Maqedoni është në kulmin e saj. Pas referendumit të dështuar, kryeministri i Maqedonisë tani të gjitha shpresat i var tek e vetmja kartë që i mbetet, raundi vendimtar, kur parlamenti i Maqedonisë të votojë për marrëveshjen me Greqinë, për të cilën janë të nevojshme dy të tretat e votave të deputetëve. Të dielën e mbrëmje ai u bëri thirrje deputetëve të opozitës që ta mbështesin. Në rast të kundërt në dhjetor do të shpallen zgjedhjet e reja. Partia në opozitë VMRO DPMN triumfon pas dështimit të referendumit dhe e shpall qeverinë e Zaevit e po ashtu edhe Marrëveshjen e Prespës me Gre-

qinë të dështuar. Pavarësisht përbetimit, se është, gjithashtu, për integrimin në BE dhe në NATO, opozita tregohet lidhur me çështjen e emrit e palëkundshme dhe pas suksesit të bojkotit të sotëm e inkurajuar.

Me luftërat në politikën e brendshme ajo po mban peng të gjithë vendin. Ajo që duket e pamundur duhet të ndodhë tani, disa deputetë nga radhët e opozitës duhet të ndryshojnë mendjen për arritjen e shumicës së nevojshme të dy të tretave. Në rast të kundërt marrëveshja me Greqinë është e dështuar, antarësimi në NATO dhe në BE do të jetë sërish i largët. Pasojat për Maqedoninë do të ishin fatale. E ardhmja e vendit sërish do të jetë më shumë se e pasigurtë.

Opinioni *i* Ditës

Të pazanët ne

Nga Arlinda Çausholli

(vijon nga faqja 1)

... vetëm shumatorja e arrogancës nëpër mikrofonin të rrjepur politikë, nga të gjitha palët që kanë në dorë ligje dhe nënligje, e që votën ia kemi dhënë, pasi e kemi shitur shpirtin me një pazar të turpshëm e të pakthyeshmë. E atyre iu lumtë.

E shitëm, në shtrembërim të kombit, në shtrembërim të njerëzve, të moralit, të fëmijëve që na pasqyrojnë dhe të ardhmes së turbullt të këtij vendi që lyhet në fasadë dhe lëngon në brendësi. Dhuna fillon që në shtëpitë tona, kur bashkëshortët i thonë njëri-tjetrit "mbylle gojën" dhe fëmija dëgjon zërin e më "të fortit" prind dhe e përcjell të shoku i lagjes.

Dhuna vazhdon në rrugë, kur hakërrehemi nëpër makina e nëpër trotuare kush të kalojë më parë, sepse ngutemi për të qenë më të fortë dhe jo se kemi ndonjë punë të mirë apo fisnike për të bërë.

Dhuna zgjatet, kur djemve vazhdojnë t'ua mbajnë derën e lokalit vajzat, sepse ata duhet të hynë me duar në xhepa e të tregojnë se katër fenerët e dritave të makinës i kanë marrë me vete edhe në tavolinë.

Dhuna stërzgjatet nëpër shkollë, nëpër kufij e prona, nëpër institucione shtetërore, ku qytetari i thjeshtë duhet të jetë i



shenjtë e të trajtohet si i tillë.

Dhuna klith në indiferencën tonë ndaj atyre që pastrojnë – me aq sa munden – rrugët dhe ndërtesat publike, kokulur, sepse askush nga ne nuk ua ngre sytë t'u thotë "puna e mbarë".

Dhuna trashet kur mungojnë fjalët e falënderimit dhe të mirënjohjes të njerëzit kalimtarë apo jo të jetës sonë, sepse kemi filluar të kemi frikë nga mirësia e butësia dhe nuk ka kanosje më të madhe se kjo.

Dhuna jehon, sepse media të vdes disa herë në emër të kliku-

meve, pa e kuptuar se bashkë me emrin e përfolur, vdes dhe ajo vetë. Titujt kryesorë u bëjnë lavazh pamor dhe mendtor të gjitha moshave, duke e sjellë jetën e ulla publikë në formën më të shëmtuar.

Gjuha mediatiqe vë në piedestal modele që nuk frymëzojnë, por shigjetojnë me pahir, kthinat më të pazhvilluara të këtij vendi, me figura që vlerat nuk i njohin. Çdo ditë, duke çoroditur vajzat që kujtojnë se trupi i ekspozuar i bën më femra dhe djemtë që mendojnë se grushti i bën më burra. Dhuna do të

trashëgohet në më të paktën tri breza, sepse 2.5 milionë shqiptarë – aq sa kanë mbetur – nuk janë në gjendje të bashkohen në një zemër të madhe, të kujdesen për veten, për tokën, për votën, për njëri-tjetrin dhe në 28 vjet kanë ndezur vetëm zjarrin e Kombëtares, sepse vetëm nga ajo ndihen të parrezikuar.

Të kemi frikë nga njëri-tjetri? Të mbrohemi nga njëri-tjetri? Nuk besoj se ka dhunë më të madhe, të përditshme dhe ngadalësisht më sfilitëse se sa kjo.

Gishtin nga vetja, zemrën nga të gjithë.

BLUE TOOTH
THASHETHEME
MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me
GAZETA SHQIPTARE

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të ndiheni të mbushur plot shpresë. Mos shpenzoni shumë për argëtim apo blerje jo të nevojshme, duke qenë se të ardhurat tuaja financiare nuk premtojnë shumë. Përpiquni të flisni me partnerin/partneren tuaj për problemet që ju mundojnë, pasi nesër do të jetë vonë.

DEMI

Prindërit e kësaj shenje do të kënaqen pamasë për shkak të performancës së fëmijëve. Sot do të jeni në qendër të vëmendjes. Gjithashtu, do të kuptoni sesa shumë ju do partneri/partnerja juaj.

BINJAKET

Prindërit e kësaj shenje do të kënaqen pamasë për shkak të performancës së fëmijëve. Sot do të jeni në qendër të vëmendjes. Gjithashtu, do të kuptoni sesa shumë ju do partneri/partnerja juaj.

GAFORJA

Sjellja e nxituar mund të shkaktojë probleme në jetën tuaj bashkëshortore. Gjendja juaj financiare do të përmirësohet gjatë ditës. Çiftet e dashuruar do të përjetojnë momente të vështira.

LUANI

Do të ndiheni shumë mirë fizikisht. Shprehni mbështetjen partnerit/partneses suaj, pasi sot nuk do të ndihet i/e lumtur. Çiftet e martuara do të përjetojnë një ditë të mrekullueshme.

VIRGJERESHA

Pikëpamjet tuaja të sinqerta mund të lëndojnë një mikun tuaj. Kujtoni që duhet të tregoheni bashkëpunues si në shtëpi, ashtu edhe në punë. Ka gjasa të debatooni me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj, pasi do të mësojë një të fshehtë, të cilën nuk e keni ndarë me të.

PESHORJA

Do të arrini një marrëveshje financiare, e cila do t'ju sjellë mjaft të ardhura. Lidhja juaj romantike do të jetë e mbushur plot shpresë dhe momente të bukura. Sot do t'ju komplotojnë për arritjet në punë.

AKREPI

Do të ndiheni mirë nga ana shëndetësore, pavarësisht stresit që keni kaluar në punë. Do të fitoni para, por përpiquni të mos shpenzoni shumë. Është koha që të merrni përgjegjësitë e duhura në familje dhe të komunikoni në mënyrë konstruktive.

SHIGJETARI

Bëni mirë të gjeni pak kohë për t'u relaksuar, pasi lodhja e tepërt do të ndikojë negativisht gjatë ditës. Në dashuri do të përjetoji momente shumë të këndshme. Nëse keni bërë ndërmend të investoni, nuk është dita e duhur.

BRICJAPI

Duhet të nisni meditimin dhe jogën për t'u ndjerë sa më mirë si fizikisht, ashtu edhe mendërisht. Dikush që ka plane dhe ide të mëdha do t'ju tërheqë vëmendjen, por bëni kujdes. Verifikoni besueshmërinë e tij.


UJORI

Sjellja juaj e mirë do të kënaqë familjen, por sa i përket anës romantike, do të zhgënjeheni, pasi partneri/partnerja juaj do të ketë shumë kërkesa ndaj jush. Pritshmëritë e larta mund t'ju çojnë drejt trishtimit.

PESHQIT

Të ardhurat financiare nuk do të përputhen me pritshmëritë tuaja. Përpiquni të mos i ofendoni personat rreth jush. Bashkëbisedimi me persona të rëndësishëm do t'ju sjellë ndërmend ide të reja.

Flamurtari u rikthye te fitorja ne kampionat, ne nje ndeshje ndaj nje kundershtari modest si: Kastrioti, qe ne Vlorë shkonte per te bere surprize. Kuqezinjte e trajnerit Ilir Daja, mposhten me "poker", 4-0 ekipin krutan, ndersa nje nga me te miret ne fushen e lojes ishte edhe mesfushori nga Argjentina, Agustin Torasa. Ne nje proncim qe ka dhene per "Rtsh Sport",



Argjentinasi është entuziast pas fitores ndaj Kastriotit

Torasa: Flamurtari u rikthye

pas fitores me Kastriotin, mesfushori me tipare sulmuese Torasa, është i bindur se skuadra e tij ka potencial qe te rivalizojë deri ne fund te sezonit per titullin kampion. "Është shumë e rëndësishme qe ne fituam. Me vjen mirë qe shënova. Jo vetëm unë, por tërë skuadra

shkoishumë mire në takimin me Kastriotin dhe tashmë është moment qe te ringrihem, pasi i kemi mundësitë". Torasa ka folur edhe ndeshjen e radhës qe luhet ne mesjavë, atë me Laçin qe zhvillohet ne mesjavë, ne transfertën kurbinase. "Kalendari?! Kemi një

përballje të vështirë, por kemi një ekip me kualitete dhe mund t'ia dalim me sukses. Ne duam titullin, kështu qe nuk është se kemi diferencë të madhe nga kreu", - 29-vjeçari Agustin Torasa, qe me fanellën e skuadrës së Flamurtarit ka shënuar dy gola këtë sezon.

TRAJNERI PORTUGEZ



Murinjo:
Nuk do jem unë ai qe do të largohet nga Junajtidi

Trajneri portugez i Mançester Junajtid, Zhoze Murinjo ka përgjeshtruar të gjitha zërat qe e largojnë atë nga "Djajtë e kuq". Në një konferencë për shtyp, strategu 54-vjeçar tha: "Nuk largohem nga Mançester Junajtid! E kuptoj se ka nevojë për ndryshime në klub, pasi për momentin nuk po kalojmë një situatë të mirë. Por nuk do të jem unë ai qe do të largohet", - tha Murinjo. Para ndeshjes kundër Valencias, Mou u duk shumë i qetë dhe deklarata e tij qe dikush do të largohet, nuk lidhet me mesfushorin francez, Pol Pogba, por me drejtorin e klubit, Ed Uduord.



Jeton Selimi

Vendimi pas takimit me presidentin dhe një takimi prej më shumë se dy orësh me lojtarët

Ze Maria: Qëndroj te Tirana, për momentin..

Braziliani mohon të jetë ndikuar nga rroga

Ze Maria i nxjerr bluf të gjithë. Në ditën kur pritej shkarkimi i tij nga Tirana, braziliani ka veshur sërish tutat dhe ka dalë në stërvitje në krye të 24 herë kampionëve. Por jo përpara një analize të gjatë. Një takim kokë më kokë me lojtarët, një mbledhje qe ka zgjatur plot dy orë e gjysmë dhe qe natyrisht nuk ka pasur në fokus kundërshtarin e radhës, por situatën në kampionat bardheblu. Marrëdhënia e Ze Marias me lojtarët dukej se kishte marrë krisjen përfundimtare menjëherë pas derbit, ndërsa edhe presidenti Halili në prononcim e tij të pasndeshjes e la të nënkuptohej se këtë javë mund të vinte edhe trajneri i ri. I fitore në gjashtë ndeshje është një ecuri prej skuadre mbijetese dhe jo për një ekip qe në letër pritej të ishte pretendet për titull. Vetë Ze Maria ka sqaruar gjithçka, ndërsa ka pranuar se për momentin nuk ka ndër mend të largohet nga Tirana. "E kërkoni shumë vetë qe unë të largohesha, por besoj qe jemi sqaruar me presidentin gjatë paradites dhe në mesditë jemi sqaru-



ar si staf teknik me lojtarët. Kemi nxjerrë në pah problemet tona si staf dhe të lojtarëve, duke i premtuar njëri-tjetrit qe të ndryshojmë nga sot e tutje. Kam

dashur qe të dëgjoj nga të gjithë lojtarët, nga kapiteni, atë çfarë kishin për të thënë dhe cili ishte mendimi i tyre. I premtova presidentit një impenjim maksimal, kjo nuk

SUPERLIGA		
Java e 5-të		
Të mërkurën		
Laçi-Flamurtari	13:45	
Kastrioti-Tirana	13:45	
Luftëtari-Kamza	13:45	
Partizani-Teuta	16:45	
Të enjten		
Skënderbeu-Kukësi	17:45	
RENDITJA		
SKUADRA	N	P
KUKËSI	6	13
PARTIZANI	6	13
SKËNDERBEU	6	11
FLAMURTARI	6	10
LAÇI	6	10
TEUTA	6	8
KAMZA	6	6
TIRANA	6	5
KASTRIOTI	6	4
LUFTËTARI	6	3

diskutohet, nuk ka ndodhur më parë dhe nuk do të ndodhë asnjëherë. Unë nuk jam këtu për të humbur kohë dhe për t'iu humbur kohë njerëzve. Nuk duam të na fyejnë e as të fyejmë njeri. Folëm për këto gjëra me presidentin dhe për momentin do të vazhdojmë, më pas të shohim çfarë do të ndodhë. Jam shumë i kënaqur qe qëndrova, pasi asnjëherë nuk e kam fshehur faktin qe ndihem shumë mirë këtu në Tiranë", -tha Ze Maria për Top-Channel. Një nga pikat shumë të diskutuara të ditëve të fundit ishte dhe kontrata e majme me brazilianit. U tha se Ze Maria nuk do të largohet pa marrë deri qindarkën e fundit të kontratës, por trajneri i Tiranës i mohon këta zëra. "Më vjen shumë keq për disa njerëz qe mendojnë se unë

këtu qëndrova për paratë, pasi këtë vit kam refuzuar një kontratë shumë të majme financiare dhe klubi e di. Unë jam një njeri qe dua ta mbyll një projekt qe filloj. 5.000 eurot qe marr nuk më ndryshojnë jetën, kjo është pak, por e sigurtë", -përfundoi tekniku Ze Maria.

TRAJNERI I LAÇIT

Mërgjyshi: Nuk më befason pathyeshmëria jonë

Trajneri i Laçit, Artan Mërgjyshi tha për mikrofonat e "RTSH Sport" se Laçi duhet të konsiderohet si një nga forcat e kampionatit dhe fakti se janë të pamposhtur nuk është një surprizë: "Ky kampionat është shumë i barabartë dhe në futboll janë të tria rezultatet. Gjithsesi ne jemi të lumtur qe nuk jemi mposhtur akoma dhe duhet të vazhdojmë sa më shumë kështu. Duhet të kishim bërë më mirë në katër barazimet qe kemi bërë, por jam i kënaqur. Golat në minutat e fundit tregojnë karakterin e



skuadrës. Nuk jemi ende në gjendje optimale, pasi shumë lojtarë të sulmit kanë ardhur në ditë e fundit. Kur të kthehet Sukaj, shpresojmë të shtojmë forcën sulmuese dhe të

jemi më efikasë në 90 minuta. Ky sezon ka shumë rivalitet dhe këtë gjë e tregojnë dhe pikët. Përfunduar Kastriotin, me gjithë respektin për ta, të tjerat janë të gjitha të barabarta. Në luftojmë për pjesën e lartë të tabelës dhe për të qenë të singertë nuk kemi objektiva konkret. Por duke parë Laçin e dy sezoneve të fundit, dihet se objektivi ynë është lart. Jemi të bindur se kemi kapacitete dhe mundësi, prandaj do të synojmë pjesën e sipërme të tabelës", - tha Mërgjyshi.

TRAJNERI SPANJOLL

Guardiola: Mbape te Siti? E pamundur


Pep Guardiola ka përgjeshtruar thashethemet qe e lidhin Mançester Siti me PSG-në, për një transferim të Kilian Mbape. U raportua se Siti ishte duke u përgatitur një ofertë prej 200 milionë paundë për Mbape në janar, me PSG-në qe punonte për të rregulluar "FairPlay" financiar. Guardiola është këmbëngulës se nuk ka plane për të shitur Sterling, megjithëse, as për të blerë Mbape. "Kjo nuk do të ndodhë", tha ai. "Ndonjëherë nuk e kuptoj ku vjen lajmi.



Mançester Siti nuk do të shpenzojnë paratë qe Mbape qe meriton, apo se meriton PSG. PSG nuk do të shesë këtë lloj lojtari për ndonjë klub tjetër në botë

në vitet e ardhshme. Kjo nuk do të ndodhë, por ne nuk do të shkëmbejmë Sterling apo një lojtar tjetër më të mirë qe kemi", -tha Guardiola.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishite dekrét i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.

38. Satelit i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstrete në sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Eshhtë gjuajjja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuraturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendi.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishite giuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihet kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsja e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë skllavëri.
16. Eshhtë shtypji po përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marfete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zill... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

5	1		7						
			6		1			4	
				9	5	2			
5	7	8					3	6	
				8	9				
3			6			8			
			1	2	7	5			
8									
	5						9	3	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	6	1	7	8	4	3	9	5
7	3	4	9	5	1	6	8	2
5	9	8	2	3	6	1	4	7
3	8	2	4	6	5	7	1	9
9	1	6	3	2	7	4	5	8
4	5	7	1	9	8	2	6	3
8	4	3	5	1	2	9	7	6
1	2	5	6	7	9	8	3	4
6	7	9	8	4	3	5	2	1

Argëtim filozofik

- Shiko mbrapa me falenderim, rreth jush me besim, perpara, me shpresë.
- Brenga e dashurisë nuk është vetëm se nuk mund të zgjasë përgjithmonë, por edhe se dëshirat e ëmbla që ajo shkakton, harrohen shpejt.
- Ndërgjegjia është thellësia e njeriut. Dashuria është gjërisia e tij.
- Cilado që ju jeni kundër, mund të riformulohet për të mbështetur diçka.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	4	1	2		3	4	6	5	3	4	1	4
1	2	8	1	5		8	4	7	10	6	4	3
10	6	7		2	7			11	6	2	1	4
10	7		15	1	12	1	2	3	4		10	1
1		12	1	4	3	2	6	4	3		1	2
4	2	6	11	3	2	6	4	3		1	14	3
1	2	4	16	2	7	16	6		18	1	4	4
	1	2	8	3	14			3	1		1	
1	19	1		4		11	3	4	2	6		15C
8	1	5	4		18	6	2	1	4	3	2	6I
	5	16	1	10	6	1	3	1	6		3	18P
10	3		15	3	18	6			14	8	14	1A

- Në vend që të jesh kundër të keqes, më mirë të jesh në favor të paqes.
- Në vend që të jesh kundër varfërisë, më mirë të jesh në favor të prosperitetit.
- Në vend që të merrësh pjesë në luftën kundër drogës, mbështetni parandalimin e tyre tek të rinjtë.
- Në vend që të jesh kundër të keqes, më mirë të jesh në favor të dashurisë.
- "Gjëja më e bukur është të shohësh një person që do, të buzëqeshë. Dhe akoma më e bukur është të dish se arsya për këtë, je ti"

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A	T		
P	L	K	A	P	A	L	I	E	N	E		
R	E	K	O	R	D	E	T	P	M	T	R	
I	A	N	S	A	M	B	L	I	H	E	M	
M	A	R	T	I	N	E	D	E	N	I	N	
O	H	A	R	A	T	T	I	T	R	A	T	
B	A	N	A	P	I	S	H	E	I			
E	P	I	T	E	T	I	E	S	T			
M	I	N	A	T	N	A	I	T	I	M	A	
T	K	A	P	A	K	R	O	J	A	R	T	
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A	R	T	
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T	O	R	I
K	A	A	S	L	U	L	I	M	A	T	A	
A	R	R	A	S	B	A	R	N	U	M	R	
L	A	I	A	B	R	O	A	E	F	I		
L	E	E	L	E	M	E	N	T	A	R	E	
A	N	E	T	A	R	E	S	T	I	A	I	N
M	I	N	I	M	A	L	A	L	E	K	O	
I	K	L	I	T	A	R	E	T	E	M	A	
E	S	E	N	I	E	R	I	E	R	I		
P	A	N	A	I	M	E	K	N	I			
E	T	N	I	E	M	I	N	E	M	A		
L	O	T	A	S	D	R	I	T	A	T		
A	L	A	I	N	E	M	I	S	A	R	E	T

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

